

EC  
MA NDRYSHE

# AKTIVIZMI NË KOMUNITET

Libërth mbi praktikat e  
mira të aktivizmit në komunitet

2020



Ky grant është financuar nga projekti 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).





# AKTIVIZMI NË KOMUNITET

Botues: EC Ma Ndryshe

Autore: Flaka Xërxa Beqiri

Rr. Fehmi Lladrovci Nr. 94, Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 222 771 & 038 224 967

2020

## **PËRMBAJTJA**

1. Hyrje – qëllimi dhe metodologjia e hartimit të udhëzuesit
2. Përshkrimi i përgjithshëm i projektit, qëllimit dhe objektivave, shtrirja gjeografike e aktiviteteve, grupet e synuara
3. Realizimi i nismave të aktivizmit – përshkrimi tekstual dhe grafik i nismave të aktivizmit
4. Lista e iniciativave të realizuara
5. Prezentimi i rasteve të mira dhe atyre më pak të mira, në krahasueshmëri me rastet e suksesit në rajon dhe botë
6. Konkluzat dhe rekomandime
7. Për EC

A vertical yellow sticky note is attached to the left side of a light-colored, textured surface. The note has a jagged, torn bottom edge. On the note, the number '7' is written in a thick, black, hand-drawn style.

7

HYRJE

## **1. Hyrje – qëllimi dhe metodologjia e hartimit të udhëzuesit**

### **1.1. Qëllimi dhe objektivat e udhëzuesit**

Ky udhëzues ka për qëllim përmbledhjen e aktiviteteve kryesore të projektit “AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës”, duke përfshirë këtu prezentimet dhe ligjëratat e mbajtura në institucionet shkollore, realizimin e komponentes së edukimit – shkollat mbi aktivizmin, aktivitetet e realizuara në terren si dhe iniciativat e ndërmarra nga nxënësit. Përmes evaluimit të pritshmërive nga realizimi i iniciativave në terren, udhëzuesi kategorizon praktikën e mira dhe ato më pak të mira, duke nxitur lexuesin në përjetimin e storjeve të suksesit.

Objektivë e udhëzuesit “AKTIVIZMI NË KOMUNITET - Libërth mbi praktikën e mira në komunitet” është gjetja e modaliteteve për nxitjen e aktivizmit dhe vullnetarizmit në komunitet, me theks te të rinjtë në zonat rurale të Kosovës, përmes shpalosjes së rezultateve të arritura gjatë projektit si dhe prezentimit të shembujve dhe praktikave të mira nga rajoni dhe bota.

### **1.2. Metodologjia**

Udhëzuesi është zhvilluar sipas metodës kualitative të hulumtimit, Qualitative Research Methodology, e cila konsiston në specifikimin e situatave duke zgjedhur si mjete intervistat, diskutimet, analizat dhe observimet. Arsyeja e zgjedhjes së kësaj metode të hulumtimit është për faktin se metoda kualitative është treguar më e suksesshme në hulumtimet që kanë të bëjnë me çështjet sociale, duke gjeneruar rezultate në fjalë dhe jo në numra, llogarira.

Me qëllim të pasqyrimit të arritjeve të projektit “AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës” përgjatë kohështrirjes së implementimit të tij, pjesë e metodologjisë së këtij publikimi është edhe dokumentimi sistematik i aktiviteteve të realizuara gjatë këtij projekti. Në bashkëveprim me stafin e projektit, është bërë sistemimi i të gjitha aktiviteteve të realizuara, duke përfshirë këtu kohështrirjen e aktivitetit, përshkrimin tekstual të tij, përshkrimin grafik të tij, lokacionin si dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve. Të dhënat e prezentuara në këtë udhëzues jo domosdoshmërisht paraqesin të gjitha aktivitetet e projektit.

Duke patur për synim kategorizimin e praktikave të mira dhe atyre më pak të mira nga rradhët e inicativave të dalura nga komuniteti (Do's and Don'ts), në kuadër të metodologjisë së aplikuar është pëzgjedhur edhe hulumtimi i dokumenteve me tematika relevante, në veçanti përmbledhja e praktikave të mira në rajon dhe në botë.

### 1.3. Tematikat

Duke ruajtur kornizën e qëllimit dhe objektivave të vet projektit, udhëzuesi kategorizohet në këto tematika të cilat edhe përbëjnë strukturën e vet dokumentit:

- ◎ Takimet në komunitet
- ◎ Anketimi me nxënësit e shkollave të mesme
- ◎ Prezentimet informuese në shkollat e mesme të Kosovës
- ◎ Dizajnimi i programit dhe realizimi i Shkollës së Aktivizmit Rural
- ◎ Realizimi i nismave të aktivizmit
- ◎ Themelimi i grupeve të komunitetit
- ◎ Mentorimi i nismave të aktivizmit dhe grupeve të reja
- ◎ Realizimi i forumeve të partneritetit

me grupeve të komunitetit

- ◎ Prezentimi i praktikave të mira të aktivizmit në komunitet në rajon dhe në botë
- ◎ Prezentimi i storjeve të suksesit Do's and Don'ts
- ◎ Rekomandimet

### 1.4. Pritshmëritë pas publikimit të udhëzuesit

Përmes publikimit të këtij udhëzuesi, audiencia e synuar do të informohet lidhur me qëllimin dhe objektivat e projektit "AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës", sfidave, arritjeve por edhe dështimeve në iniciativat/aktivitetet e ndërmarra përgjatë kohështirjes së projektit. Më e rëndësishmja, udhëzuesi do të informojë komunitetin e gjerë, me theks te të rinjt, mbi rëndësinë e aktivizmit të të rinjve dhe kontributit të tyre në transformimet që mund të pësojë një hapësirë, mjedis, fshat apo zonë urbane; mundësitë e rritjes potenciale të aktivizmit në mënyrën e të menduarit tek ne si shoqëri; arritjet përmes intervenimeve konkrete në të mirë të komunitetit etj.

Analizat krahasuese me rastet e suksesit në

rajon dhe botë kanë për qëllim në stimulimin e të rinjve për aktivizëm më të theksuar në të ardhmen, për stimulimin e tyre për një performancë më të lartë, vetë-analizë të përparësive dhe mangësive në realizimin e iniciativave të ndërmarra nga ata, nxitje për organizim të komunitetit për ndërmarrjen e reformave dhe zhvillimit socio-kulturor etj.



2

RRETH PROJEKTIT

## 2. Përshkrimi i përgjithshëm i projektit, qëllimit dhe objektivave, shtrirja gjeografike e aktiviteteve, grupet e synuara

### 2.1. Rreth projektit “AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës”

Projekti “AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës” ka patur për synim të kontribuojë në zbutjen e niveleve të përjashtimit social të të rinjve në zonat rurale duke rritur mundësitë e angazhimit të tyre në nisma të aktivizmit, vullnetarizëm dhe aktivitete jashtë kurrikulare. Përfitues kryesorë të projektit cilësohet të jenë: të rinjt (vajza dhe djem) në zonat rurale të Kosovës të përkatësive të ndryshme etnike. Ndërsa në implementimin e projektit janë përfshirë palë të instancave të ndryshme, përfshirë këtu: institucionet komunale, shkollat e mesme, këshillat e fshatrave, grupet e organizuara të komunitetit, organizatat e shoqërisë civile, grupet jo formale dhe mediat lokale.

### 2.2. Ciklet përbërëse dhe shtrirja gjeografike

Projekti “AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës” është

realizuar në pesë cikle, me shtrirje të ndryshme gjeografike, duke përfshirë përkitazi këto Komuna:

#### CIKLI I



Komuna e Prizrenit,  
Komuna e Dragashit,  
Komuna e Therandës,  
Komuna e Mamushës,  
Komuna e Gjakovës,  
Komuna e Malishevës  
Komuna e Rahovecit

#### CIKLI II



Komuna e Pejës,  
Komuna e Deçanit,  
Komuna e Junikut,  
Komuna e Klinës  
Komuna e Istogut

#### CIKLI III



Komuna e Gjilanit,  
Komuna e Ferizajit,  
Komuna e Shtimes,  
Komuna e Kaçanikut,  
Komuna e Kamenicës,  
Komuna e Hanit të Elezit  
Komuna e Shtërpcës

#### CIKLI IV



Komuna e Drenasit,  
Komuna e Lipjanit,  
Komuna e Mitrovicës,  
Komuna e Obiliqit,  
Komuna e Skënderajit  
Komuna e Vushtrrisë

#### CIKLI IV



Komuna e Prishtinës,  
Komuna e Podujevës  
Komuna e Fushë Kosovës

### 2.3. Aktivitetet kryesore të projektit "AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës"

Aktivitetet kryesore të projektit "AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës" cilësohet të jenë:

#### PREZANTIMI I PROJEKTIT NË SHKOLLA:

Ligjërata mbi rëndësinë e aktivizmit dhe vullnetarizmit dhe informata të përgjithshme mbi projektin janë realizuar në 24 Komuna, përfshirë këtu 60 shkolla me

gjithsej 1885 pjesëmarrës. Përkitazi, nga ligjëratat e realizuara në shkolla në ciklin e parë kanë përfituar 455 nxënës, në ciklin e dytë 305 nxënës, në ciklin e tretë 570 nxënës, në ciklin e katërt 285 nxënës dhe në ciklin e pestë 270 nxënës. Për këtë aktivitet është marrë leje nga MASHT në fillim të zbatimit të projektit, janë siguruar pëlqimet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në komnatat përkatëse dhe prezantimet janë koordinuar me drejtorët e shkollave.




	CIKLI I	CIKLI II	CIKLI III	CIKLI IV	CIKLI V
	230	163	252	163	153
	255	142	318	122	117


## REALIZIMI I SHKOLLËS SË AKTIVIZMIT:

Përkitazi me komunat e synuara janë realizuar gjithsej pesë cikle të Shkollës së Aktivizmit. Këto cikle të edukimit mbi aktivizmin janë realizuar përgjatë tri ditëve me synim në informimin e nxënësve pjesëmarrës për tema të caktuara mbi aktivizmin, ligjërata nga ekspertët përkatës si dhe punë grupore e mentoruar nga mentorët e fushave përkatëse. Statistikisht, të përfshirë në pesë ciklet e Shkollës së Aktivizmit rezultojnë të jenë: 150 të rinj pjesëmarrës, 15 ligjërues të temave të ndryshme, 15 trajnerë dhe mentorë dhe 25 grupe të themeluara.

Si formacion, Shkolla e Aktivizmit ka patur këto shtylla kryesore organizative:



Trajnimet dhe ligjëratat mbi aktivizmin



Realizimi i nismave të aktivizmit



Themelimi i grupeve të reja të komunitetit

Disa nga temat të cilat janë elaboruar gjatë cikleve të ndryshme të Shkollës së Aktivizmit janë:

- Vullnetarizmi dhe aktivizmi në mesin e të rinjve
- Përgjegjja e të rinjve kundrejt ndryshimeve klimatike
- Roli i të rinjve në planifikim - aktivizmi dhe gjithëpërfshirja
- Metodatat e hulumtimit, aktet ligjore dhe marrëdhëniet me publikun dhe median



## TRYEZAT INFORMUESE:

Në forumet përmblylëse të pesë cikleve përkatëse të Shkollës së Aktivizmit është bërë rikapitulumi i tërë procesit të nëpër të cilin kanë kaluar pjesëmarrësit, që nga pjesëmarrja në ciklin e edukimit, propozimi dhe ideimi i iniciativave e deri te realizimi i tyre. Përgjatë tryezave informuese është bërë përmbledhja e iniciativave të realizuara dhe atyre në proces. Forumet kanë shërbyer edhe për çertifikimin e pjesëmarrësve të cilët suksesshëm kanë përfunduar “Shkollën për aftësimin e të rinjve për aktivizëm në komunitet”. Ndër qëllimet më madhore të këtyre takime ka qenë inicimi i bashkëpunimit të mëtutjeshëm në mes të institucioneve të përfshira në proces dhe nxënësve të cilët kanë dhënë propozimet për intervenime të caktuara me qëllim të kontributit të tyre në komunitet.



## NISMAT E AKTIVIZMIT - INICIATIVAT:

Mësimet nga cikli i edukimit mbi aktivizmin, dhe identifikimi i problemeve nga komuniteti prej nga vijnë, ka rezultuar në ideimin dhe realizimin e një sërë iniciativash të ndërmarra nga nxënësit aktivisht të përfshirë në projekt. Rrjeti i iniciativave të zhvilluara përgjatë shtrirjes dy vjeçare të projektit shënon 26 Komuna dhe 18 zona rurale. Gjithsej janë realizuar 88 nisma të aktivizmit, të cilat varësisht nga natyra e problemeve të identifikuara, variojnë në përmbajtje dhe formacion.

Përgjithësisht, iniciativat e realizuara mund të kategorizohen në: intervenime direkte, kërkesa zyrtare, peticione, trajnime, kampanja vetëdijesuese dhe aktivitete kulturore. Rrjedhimisht, të përfshirë direkt në këto iniciativa rezultojnë të jenë 1 350 persona, ndërsa përfitues indirekt rreth 15 000 persona. Duke qenë se secila iniciativë e realizuar është shpalosur në rrjetet sociale, konsiderohet se ato kanë arritur ndikueshmëri tek 338 922 persona. Ky libërth përmbledh një numër të konsiderueshëm të iniciativave të realizuara, të cilat përkrijnë kryesisht me intervenimet direkte.



### 2.3. Të arriturat kryesore të projektit "AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës"

Duke u nisur nga anketimi i zhvilluar në fillim të projektit dhe duke vazhduar edhe përgjatë implementimit të tij, ka rezultuar se të rinjt kanë shumë pak mundësi që të jenë pjesë e proceseve të cilat dërgojnë në përmirësim të jetës në komunitet. Atyre nuk u është ofruar mundësia e informimit të denjë mbi aktivizmin dhe vullnetarizmin dhe si rezultat i kësaj kanë njohuri minimale mbi rolin dhe mënyrën e aktivizmit dhe vullnetarizmit. Projekti ka identifikuar si problem kryesor faktin se të rinjt e Kosovës, veçanërisht ata nga zonat rurale, veprojnë kryesisht brenda lokaliteteve të tyre dhe pa mundësi ekspozimi me të rinjt e komunave të tjera. Rrjedhimisht ky projekt u ka mundësuar të rinjve pjesëmarrës, dhe atyre të cilët kanë përfituar indirekt nga realizimi i nismave të aktivizmit, që të jenë më të vetëdijshëm për rolin e tyre në komunitet,

mundësitë për të marrë vendime dhe për të ndikuar në procese të ndryshme të komunitetit të tyre, por edhe për të bashkëvepruar me institucione të rëndësishme nga vendet prej nga ata vijnë. Poashtu, projekti ka ndikuar në socializimin dhe shkëmbimin e përvojave të ndryshme në mes të nxënësve të zonave të ndryshme, të cilët kanë arritur në krijimin e grupeve jo-formale të komunitetit të cilat do të vazhdojnë të funksionojnë edhe pas përfundimit të projektit "AktRural".

Statistikisht dhe programatikisht projekti konsiderohet të ketë shënuar këto arritje:

- Mbi 150 të rinj dhe të reja të zonave rurale të aftësuar dhe bartës ose pjesë e nismave të aktivizmit në nivel të komunitetit ku ata jetojnë
- Mbi 50 nisma të aktivizmit në zona rurale kanë përmirësuar cilësinë e jetës së komunitetit përmes adresimit të nevojave specifike të banorëve;
- Mijëra të rinj të angazhuar në realizimin e nismave të aktivizmit dhe qindra prej tyre pjesë e grupeve të reja të komunitetit (ose grupeve ekzistuese)
- Mbi 20 grupe të reja të komunitetit të themeluara
- Mundësi të rritura për angazhim të të rinjve në zonat rurale në nisma të aktivizmit, vullnetarizëm, aktivitete jashtë kurrikulare

3

INICIATIVAT



INTERVENIM NË  
"KLASA NË NATYRË"  
TË SHKOLLËS  
FILLORE "EMIN  
DURAKU"



PRIZREN



## INTERVENIM NË “KLASA NË NATYRË” TË SHKOLLËS FILLORE “EMIN DURAKU”, PRIZREN

EC Ma Ndryshe me kërkesë të shkollës fillore "Emin Duraku" në Prizren ka bërë vendosjen e dy tavolinave në hapësirën e cila është destinuar për të zhvilluar mësimin në natyrë. Duke qenë se kësaj pjese i kanë munguar ulëset, bazuar në kërkesën e nxënësve dhe stafit të shkollës, EC ka vendosur dy të tilla duke e vënë në funksion realizimin e mësimin në ambientet e hapura për nxënësit e kësaj shkolle.

Zhvillimi i mësimin në ambiente të hapura është dëshmuar të jetë produktiv në shumë aspekte. Studimet tregojnë që në këtë mënyrë nxënësit përfshihen në procesin mësimor me një motivim më të rritur dhe me më shumë kreativitet. Mësimi në natyrë madje inkurajon edhe bashkëveprimet shoqërore duke përmirësuar marrëdhëniet mes nxënësve gjatë procesit të mësimin.





BIBLIOTEKA PËR  
SHKOLLËN FILLORE  
"MOTRAT QIRIAZI"  
& "NAZIM  
KOKOLLARI"



PRIZREN



## **BIBLIOTEKA PËR SHKOLLËN FILLORE "MOTRAT QIRIAZI" & "NAZIM KOKOLLARI", PRIZREN**

Shkollat "Motrat Qiriazhi" dhe "Nazim Kokollari" në Prizren kanë shfaqur si kërkesë furnizimin e bibliotekave të tyre me libra shkollor, meqenëse një numër i madh i titujve që parashihen të lexohen me kurrikulën shkollore kanë munguar. Kërkesën e tyre këto shkolla e kanë drejtuar tek Biblioteka e Qytetit dhe Këndi Amerikan në Prizren andaj EC në bashkëpunim me këtë institucion ka mundur që të bëhet furnizimi i tyre me titujt të cilët i kanë propozuar vet shkollat. Përmes kësaj nisme, EC konsideron të ketë ndikuar në përmirësimin e kushteve esenciale për zhvillimin e mësimin në këto shkolla, duke bërë njëkohësisht thirrje tek institucionet që të kontribuojnë në promovimin e leximit tek të rinjtë përmes pasurimit të bibliotekave shkollore.





VENDOSJA E  
FILTRUESVE  
BIOLOGJIK TË AJRIT  
NË LABORATORET E  
SHKOLLËS FILLORE  
"IBRAHIM FEHMU"



PRIZREN



## VENDOSJA E FILTRUESVE BIOLOGJIK TË AJRIT NË LABORTORET E SHKOLLËS FILLORE "IBRAHIM FEHMU", PRIZREN

Në tri kabinetet e shkollës "Ibrahim Fehmiu" në Prizren janë vendosur myshqet si filtrues biologjik të ajrit. Duke marrë parasysh që myshqet janë luftues të rëndësishëm të ndotësve të ajrit si pluhuri dhe agjentëve të tjerë siç janë grimcat e tymit, myku dhe gazrat kimik, EC në bashkëpunim me nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës "Ibrahim Fehmiu" ka vendosur që të bëj vendosjen e këtyre filtruesve. Filtruesit biologjik të ajrit siç janë myshqet kanë një rol të madh edhe në rregullimin e temperaturës së hapësirës duke e freskuar ajrin përmes rregullimit të nivelit të lagështisë. Ky është një nga atributet më interesante dhe më të dobishme të myshkut - që mund të absorbojë lagështi nga ajri kur lagështia është e lartë dhe pastaj ta lëshojë përsëri në ajër kur lagështia është e ulët.

Prandaj ky intervenim cilësohet i një rëndësie të lartë në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe në kontributin për një shëndet më të mirë tek nxënësit që e frekuentojnë këtë hapësirë.



VENDOSJA E  
ULËSEVE NË  
OBORRIN E  
SHKOLLËS FILLORE  
"GËRNÇARE"



PRIZREN

## VENDOSJA E ULËSEVE NË OBORRIN E SHKOLLËS FILLORE “GËRNÇARE”, GËRNÇARE- PRIZREN

Pas takimeve të zhvilluara me të rinjtë e fshatit Gnjare, është identifikuar mungesa e ulëseve në hapësirat e lira në oborrit e Shkollës Fillore “Gnjare”. Duke patur në fokus rëndësinë e shfrytëzimit të hapësirave gjelbëruese gjatë qëndrimit të nxënësve në shkollë, dhe mundësinë e realizimit të aktiviteteve të ndryshme në ambient të hapur, EC ka ndërmarë iniciativën për vendosjen e ulëseve në kuadër të oborrit të kësaj shkolle. Ulëset e vendosura njëherit do të ndihmojnë të rinjtë që të socializohen në mes vete dhe t’i shfrytëzojnë këto hapësira për diskutime dhe kalimin e kohës së lirë, jashtë aktiviteteve kurrikulare.



<https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/247789599590527/>





SHFAQJE TEATRALE NË  
SHKOLLËN E MESME  
PROFESIONALE "ABDYL  
RAMAJ" SHIROKË &  
"VASO DASHË  
SHKODRANI" LESHAN



SUHAREKË






## SHFAQJE TEATRALE NË SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE “ABDYL RAMAJ” SHIROKË & “VASO PASHË SHKODRANI” LESHAN, SUHAREKË

Interesimi për çështjet gjinore dhe sociale ka shfaqur si nevojë trajtimin e këtyre temave përmes aktiviteteve kulturore, përkatësisht përmes shfaqjes teatrale që si temë kishte të drejtën e gruas në trashëgimi, barazinë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve. Bazuar në nevojën e madhe për të trajtuar këto tema që në filltet e para të edukimit të rinjëve, EC ka organizuar këtë shfaqje teatrale në Shkollën Filllore “Vaso Pashë Shkodrani” në Leshan dhe “Abdyl Rama” në Shirokë të Komunës së Suharekës. Nxënësit e shkollave të lartpërmendura kanë patur rastin të shohin një skenë ku trajtohen temat e lartpërmendura dhe të bëhen pjesë e një diskutimi ku kanë bërë pyetje dhe kanë marrë informacione të reja mbi mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe barazinë gjinore. Shfaqja në fjalë është realizuar në regji të Ekrem Sopit, me dramaturg Alban Mujën dhe aktorë Valmira Hotin dhe Labinot Lajçin.






DHURIM I  
LIBRAVE PËR  
SHKOLLËN  
"MITRUSH  
KUTELI"



PRISHTINË

## DHURIM I LIBRAVE PËR SHKOLLËN “MITRUSH KUTELI”, PRISHTINË

Shkolla “Mitrush Kuteli” në Prishtinë pas takimeve që ka pasur me EC-in ka shfaqur si shqetësim mungesën e shumë titujve në bibliotekën e kësaj shkolle. Bazuar në shqetësimin e nxënësve të kësaj shkolle mbi mungesën e informimit dhe çasjes në literaturë shkollore, EC ka shqyrtuar mundësinë dhe ka realizuar këtë këkesë duke dhuruar për shkollën në fjalë mbi 100 libra. Gjatë ceremonisë së dhurimit të librave, EC poashtu u ka bërë thirrje institucioneve që t’i kushtojnë vëmendje këtij shqetësimi dhe të kontribuojnë në promovimin e leximit tek të rinjtë përmes ofrimit të bibliotekave të pasura, pasi që ky do të ishte një investim direkt në ngritjen akademike të rinisë.





SHPËRNDARJA E  
TORBAVE  
EKOLOGJIKE PËR  
REDUKTIMIN E  
QESEVE TË  
PLASTIKËS



PRIZREN



## **SHPËRNDARJA E TORBAVE EKOLOGJIKE PËR REDUKTIMIN E QESEVE TË PLASTIKËS, PRIZREN**

Kjo iniciativë është realizuar me qëllim që të ngritet si çështje përdorimi i madh dhe pasojat që shkaktohen nga qese të shumta të plastikës në vendin tonë. EC ka vendosur t'i shpërndajë nëpër disa pika të shitjes në Prizren disa torba të tilla ekologjike në mënyrë që konsumatorët të shërbehen me to në vend të të qeseve të plastikës. Këto torba ekologjike përmbajnë mesazhin "EC pa plastikë" dhe një fotografi ku paraqiten pasojat e qeses për jetën detare. Torbat eko-miqësore janë një mundësi e mirë për të treguar kujdesin ndaj mjedisit, pasi që ato mund të ripërdoren dhe të reduktojnë ndotjen e madhe që po shkaktohen nga plastika.



Iniciativa është bazuar në diskutimet me të rinjtë lidhur me ndotjen e vazhdueshme të mjedisit nga produktet e plastikës, dhe faktit se përdorimi i qeseve të plastikës po vazhdon të rritet, duke paraqitur kanosje. Të dhënat e Earth Counts këtë vit pritet që të përdoren mbi 5 trilionë qese të plastikës, më saktësisht 160 000 çdo sekondë dhe më pak se 1% nga to riciklohen dhe reduktohen si ndotje. Pjesa tjetër e këtyre qeseve përfundon në ambient të hapur duke shkaktuar degradim të natyrës dhe dëmtim të botës ujore. Dihet që qeset plastike nuk biodegardojnë, ato fotodegrodin - duke u zbërthyer në copa toksike më të vogla dhe një proces i tillë i toksifikimit të ambientit zgjat deri 400 vjet.





VENDOSJA E  
SHPORTAVE PËR  
MBETURINA,  
GLOBOÇICË



DRAGASH

## VENDOSJA E SHPORTAVE PËR MBETURINA, GLLBOÇICË - DRAGASH

Pas punëtorisë së realizuar me të rinjtë e Komunës së Dragashit, EC ka realizuar kërkesën e të rinjve të fshatit Gllboçicë, të cilët kanë kërkuar që të bëhet vendosja e shportave për mbeturina në qendrën e fshatit. Mungesa e shportave të tilla ka qenë shqetësuese për banorët e këtij vendbanimi të cilët kanë identifikuar si të jetë problematike faktin që mbeturinat janë duke u hedhur në ambiente të hapura, prej nga qarkullojnë në tërë vendbanimin, duke rrezikuar edhe shpërndarjen e epidemive. Realizimi i kësaj iniciative konsiderohet të jetë një hap direkt drejt krijimit të një ambienti më ekologjik dhe pa mbeturina, që siguron mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, mbajtjen pastër të hapësirave publike dhe promovimin e një jete më të shëndetshme në komunitet.





DEBAT "AGJENDA  
E GJELBËR E  
ZHUPËS - SFIDË  
APO POTENCIAL"



PRIZREN



## DEBAT "AGJENDA E GJELBËR E ZHUPËS - SFIDË APO POTENCIAL", PRIZREN

EC në bashkëpunim me OJQ "Sofra" kanë mbajtur një debat të hapur me panelistët, përfaqësues të fshatrave nga rajoni i Zhupës si dhe shumë të interesuar të tjerë, lidhur me mbrojtjen e mjedisit, pasurinë natyrore që posedon kjo pjesë si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet.

Para të pranishmëve është paraqitur Agjenda e Gjelbër e Zhupës, e cila është hartuar së bashku me grupet e ndryshme të komunitetit të kësaj ane, si iniciativë fillestare për mbrojtjen dhe zhvillimin e potencialit natyror që posedon rajoni i Zhupës. Gjatë tryezës poashtu është prezentuar biodiversiteti që Parku Nacional "Sharri" disponon, potencialin e tij turistik por edhe sfidat me të cilat ballafaqohet. Është diskutuar edhe nevoja e menjëhershme e ndalimit të ndërtimit të hidrocentraleve dhe ndërtimeve pa leje të cilat janë duke i shkaktuar një dëm të pariparueshëm natyrës së kësaj ane.





FURNIZIMI I  
LABORATORIT TË  
KIMISË ME ENË  
LABORATORIKE NË  
SHKOLLËN E MESME  
"XHEVDET DODA"




PRISHTINË

## FURNIZIMI I LABORATORIT TË KIMISË ME ENË LABORATORIKE NË SHKOLLËN E MESME “XHEVDËT DODA”, PRISHTINË

Shkolla e Mesme “Xhevdet Doda” në Prishtinë është furnizuar me enë laboratorike. Kjo iniciativë është ideuar nga Elmedina Ramadani, nxënëse e Shkollës së Aktivizmit dhe nxënëse e këtij Gjimnazi, e cila ka identifikuar këtë mungesë në shkollën e saj. Rrjedhimisht EC ka mundësuar furnizimin e laboratorit të kimisë me enë për kryerjen e eksperimenteve kimike. Me këtë rast stafi i shkollës ka potencuar që ky intervenim do t’i ndihmojë shumë nxënësve të shkollës sepse mjetet që ka pasur shkolla tani më janë jashtë përdorimit për shkak që gjenden për një kohë të gjatë dhe nuk janë funksionale.

Realizimi i kësaj iniciative ka ndikuar në përmirësimin e zhvillimit të lëndës në fjalë për gjeneratat e tanishme dhe gjeneratat që do të vijjnë në të ardhmen në këtë shkollë.





LIQJËRATË  
"ORIENTIMI NË  
KARRIERË"



PRISHTINË



## LIGJËRATË “ORIENTIMI NË KARRIERË”, PRISHTINË

Në Shkollën e Mesme Ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtina” është mbajtur ligjeratë “Orientimi në karrierë” e cila ka dal si kërkesë e nxënësit të Shkollës së Aktivizmit, Ardit Mulliqi.

Kjo ligjëratë është mbajtur nga Melodika Abrashi dhe ka patur për synim t’i njoftojë nxënësit e shkollave të mesme rreth përgatitjeve për zgjedhjen e profesionit të tyre. Në ligjëratë kanë qenë të pranishëm mbi 30 nxënës, të cilët pas përfundimit të ligjëratës kanë qenë të lirë për diskutim. Ligjerata u ka shërbyer atyre që të krijojnë një vizion për të ardhmen e tyre personale, por edhe si shoqëri, mbi nevojën e zhvillimit të profesioneve të caktuara





LIGJËRATË  
"AKTIVIZMI I TË  
RINJVE DHE  
RËNDËSIA E  
VULLNETARIZMIT"



GJAKOVË

## LIGJËRATË “AKTIVIZMI I TË RINJVE DHE RËNDËSIA E VULLNETARIZMIT”, GJAKOVË

Dedikuar audiencës së rinisë së Komunës së Gjakovës është mbajtur trajnimi i titulluar "Aktivizmi i të rinjve". Në këtë trajnim para pjesëmarrësve është prezantuar rëndësia e qytetarisë aktive dhe mënyrat se si përmes vullnetarizmit mund të kontribuohet në komunitet. Ky trajnim është mbajtur në hapësirat e KVRL Gjakovë dhe është udhëhequr nga Ideal Zhaveli. Të rinjtë në këtë trajnim kanë kontribuar duke ndarë me njëri tjetrin përvoja të ndryshme përmes të cilave kanë ngritur çështje të ndryshme dhe kanë shprehur ide të cilat mund t'i shtyjnë përpara së bashku.





INTERVENIM  
EKOLOGJIK NE  
RRUGËN "SHEFQET  
SHKUPI" NË  
PRISHTINË



PRISHTINË





## INTERVENIM EKOLOGJIK NE RRUGËN “SHEFQET SHKUPI” NË PRISHTINË

Në takim me banorët e rrugës “Shefqet Shkupi” në Prishtinë janë diskutuar një sërë problemesh që i preokupojnë ata në raport me lagjen në të cilën jetojnë. Ndër nevojat më prioritare të tyre ka rezultuar të jenë vendosja e tabelave informuese për njoftimet e lagjes, vendosja e policëve të shtrirë për rritjen e sigurisë të këmbësorët, vendosja e pengesave për parkimin e veturave, ndërrimi i shtyllave elektrike të cilat janë të dëmtuara si dhe rregullimi i ndriçimit publik. Shqetësim tjetër i banorëve të kësaj lagje ishte mungesa e hapësirave të gjelbra andaj EC ka vendosur të intervenojë duke mbjellur një numër të bimëve në hapësirat e kësaj lagjeje.





SHFAQJA TEATRALE  
"BARAZIA GJINORE,  
E DREJTA E GRUAS  
NE PRONË DHE TË  
DREJTAT E  
FËMIJËVE"



SUHAREKË



## SHFAQJA TEATRALE “BARAZIA GJINORE, E DREJTA E GRUAS NE PRONË DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE”, NË GJINOC & SHIROKË, SUHAREKË

Si rezultat i nevojës së luftimit të botëkutimeve patrarkale në mesin e të rinjëve (dhe jo vetëm), shfaqja teatrale me titull “Barazia gjinore, E drejta e gruas në pronë dhe Të drejtat e fëmijëve” është parë e nevojshme që të prezentohet rradhazi në disa komuna të Kosovës, përfshirë këtu fshatrat Gjinoc, Korishë, Bardhosh dhe Sllatinë e Madhe. Praktikisht kjo shfaqje është prezentuar në ShFMU “Migjeni” në Gjinoc të Suharekës, në ShFMU “Dëshmorët e Kabashit” në Korishë të Prizrenit, në ShFMU “Anton Zako Çajupi” në fshatin Bardhosh si dhe në ShFMU “Bajram Curri” në Sllatinë të Madhe.



Artistët kanë realizuar shfaqjen duke përcjellur mesazhin se të drejtat mes burrave e grave duhet të jenë të barabarta në çdo aspekt duke vënë theksin në çështjen e të drejtës së gruas në trashëgiminë e pronës. Gjithashtu është zhvilluar edhe një bisedë me nxënësit duke i njoftuar ata për të drejtat e tyre, dhe mënyrat e raportimit në rast të shkeljes së këtyre të drejtave.



[https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/2234423113326284/?epa=SEARCH\\_BOX](https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/2234423113326284/?epa=SEARCH_BOX)



Ndërtimi i raftit dhe pasurimi i bibliotekës me libra është iniciativë e të rinjve të fshatit Grnçare.



Kjo iniciativë është realizuar në kuadër të projektit Akt Rural i cili financohet nga projekti 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



RAFT DHE LIBRA NË  
GJUHËN  
BOSHNJAKE PËR  
BIBLIOTEKËN E  
SHKOLLËS  
"GËRNÇARE"



PRIZREN



## **RAFT DHE LIBRA NË GJUHËN BOSHNJAKE PËR BIBLIOTEKËN E SHKOLLËS “GËRNÇARE”, PRIZREN**

Çështja e mungesës së bibliotekave është shfaqur si problematikë në të gjitha shkollat bashkëpunuese, ku të rinjtë kanë shfaqur si nevojë mundësinë e qasjes në literaturë në gjuhën shqipe si dhe në gjuhë të tjera, varësisht nga përkatësia etnike e nxënësve që vijojnë mësimin në shkolla të caktuara. Të rinjtë të fshatit Gërçare poashtu pas takimeve të zhvilluara me EC kanë shprehur si shqetësim mungesën e librave në gjuhën boshnjake si dhe mungesën e inventarit për bibliotekë në Shkollën Fillore “Gërçare” që gjendet në vendbanimin e tyre.



EC në bashkëpunim me të rinjtë të fshatit si dhe me OJQ “Sofra” kanë bërë grumbullimin e një numri të konsiderueshëm të librave të cilat janë akomoduar në një raft të cilin e ka ofruar organizata. Përmes këtij intervenimi simbolik, EC ka bërë thirrje në vazhdimin e kësaj iniciative edhe nga palë të tjera, me qëllim të zgjerimit të bibliotekës dhe pasurimit me tituj të rinj, e gjitha në shërbim të nxënësve të këtij vendbanimi.





LIQJËRATË  
"RËNDËSIA DHE  
PËRFITIMET E  
RICIKLIMIT"



PODUJEVË

## LIGJËRATË “RËNDËSIA DHE PËRFITIMET E RICIKLIMIT”, PODUJEVË

Me qëllim të ndërgjegjësimit të të rinjëve mbi rëndësinë e riciklimit, EC ka realizuar ligjëratën me tëmë “Rëndësia dhe përfitimet e Recikimit” në tre shkolla të qytetit të Podujevës, përkatësisht në ShFMU “Enver Maloku”, “Naim Frashëri” dhe “Ibrahim Rugova”. Gjatë kësaj ligjërate nxënësit kanë fituar njohuri për komponentën e riciklimit në përgjithësi duke u fokusuar në riciklimin e letrës.

Të pranishëm kanë qenë kryetarët e secilës klasë të cilët pas ligjëratës janë furnizuar me shporta në të cilat do të bëhet grumbullimi i letrës. Kjo ide ka dal nga nxënësit e Shkollës së Aktivizmit Leart Durmishi dhe Agnesa Fazliu të cilët kanë kontaktuar edhe me Kompaninë ‘Durmishi’, kompani kjo e cila bën grumbullimin e letrës, të cilët tash e tutje do t’i mbledhin letrat edhe në këto tre shkolla. Kjo iniciativë ka dëshmuar se të rinjtë mund të bëhen akterë lidhës në mes të institucioneve shkollore dhe ndërmarjeve private në emër të kauzave të cilat përmirësojnë jetën në komunitet.





INTERVENIM  
ARTISTIK SI  
THIRRJE PËR MË  
SHUMË  
GJELBËRIM



FUSHË KOSOVË





## INTERVENIM ARTISTIK SI THIRRJE PËR MË SHUMË GJELBËRIM, FUSHË KOSOVË

Me qëllim të adresimit të një shqerësimi i cili lidhet me komponenten vizuale të Fushë Kosovës, është realizuar intervenimi artistik i cili konsiston në ndryshimin e pamjes vzeue të shtyllave elektrike në këtë vendbanim. Nga struktura betoni dhe metalike, ato janë shëndëruar në hapësira figurativisht gjelbëruese, përmes ngjitëseve të cilat përkojnë me simbole të gjelbërimit.



Kjo iniciativë është ideuar nga nxënësi i Shkollës së Aktivizmit Aldonit Thaçi i cili ka pasur si shqetësim gjendjen vizuale të shtyllave elektrike dhe mungesën e gjelbërimit në Komunën e tij. Prandaj qëllimi i tij përmes këtij aktiviteti ka qenë përcjellja e një mesazhi tek qytetarët dhe institucionet se si do të dukej qyteti me zëvendësimin e çdo shtylle elektrike me një pemë në këmbim të krijimit të një ambienti më ekologjik.





AKSION  
PASTRIMI DHE  
FUSHATË  
VETËDINESUESE



MAMUSHË



## AKSION PASTRIMI DHE FUSHATË VETËDIJESUESE, MAMUSHË

EC Ma Ndryshe dhe KVRL në Mamushë kanë realizuar një aksion pastrimi në disa nga hapësirat në këtë komunë dhe kanë shpërndarë fletushkat me mesazhe vetëdijesuese duke synuar pastrimin e këtyre hapësirave dhe ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e mjedisit të pastër. Nxënësit, të rinjtë dhe EC kanë pastruar këto pjesë duke mbledhur një sasi të madhe të mbeturinave dhe duke e përcjellë mesazhin se mbrojtja e mjedisit duhet të jetë dhe të mbetet qëllimi dhe detyra kryesore e gjeneratave të reja dhe shoqërisë në tërësi.



Ky aksion, përveç se ka shërbyer si një aksion i nisur për të krijuar një ambient më të pastër nga mbeturinat, ka shërbyer edhe si një protestë mbi praktikën e aplikuar shpesh së fundmi e cila konsiston në shndërrimin e zonave të gjelbra në deponi mbeturinash.





LIGJERATË MBI  
AKTIVIZMIN  
QYTETAR



DRAGASH

## LIGJERATË MBI AKTIVIZMIN QYTETAR, DRAGASH

Kjo iniciativë ka përfshirë realizimin e ligjeratave me temat "Aktivizam mladih u ruralnim sredinama - Aktivizmi i të rinjve në zonat rurale" me të rinjtë e fshatit Gërçare si dhe "Volontarizam i Civilni Aktivizam na Kosovu - Vullnetarizmi dhe aktivizmi qytetar në Kosovë " me të rinjtë e komunës së Dragashit. Në këto ligjërata kanë qenë prezent nxënës të grupmohave të ndryshme para të cilëve ligjëruesit kanë prezantuar përvojat e tyre lidhur me aktivizmin e tyre në shoqëri si dhe dobitë që sjellin qytetarët aktiv dhe të gatshëm për iniciimin e procesve në të mirë të komunitetit. Pas prezantimit nxënësit kanë punuar në grupe ku kanë shprehur ide të ndryshme që duan t'i implementojnë në vendbanimin e tyre si dhe kanë identifikuar problemet me të cilat ata ballafaqohen si grup i nënpërfaqësuar.





SHFAQJA TEATRALE  
"BARAZIA GJINORE,  
E DREJTA E GRUAS  
NE PRONË DHE TË  
DREJTAT E  
FËMIJËVE"



RAHOVEC



## SHFAQJA TEATRALE “BARAZIA GJINORE, E DREJTA E GRUAS NE PRONË DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE”, NË FORTESË - RAHOVEC

Me qëllim të trajtimit të disa temave sociale dhe diskutimit të tyre ndërmjet nxënësve dhe aktorëve, para nxënësve të shkollës filllore “LIRIA” në Fortesë të Rahovecit është realizuar një shfaqje teatrale. Temat që i ka trajtuar kjo shfaqje janë: Barazia gjinore; E drejta e gruas në pronë dhe Të drejtat e fëmijëve. Artistët kanë realizuar shfaqjen duke përcjellur mesazhin se të drejtat mes burrave e grave duhet të jenë të barabarta në çdo aspekt duke vënë theksin në çështjen e të drejtës së gruas në trashëgiminë e pronës. Në fund është zhvilluar një bisëde ndërmjet artistëve dhe nxënësve, ku këta të fundit janë njoftuar mbi të drejtat e tyre dhe mënyrat e raportimit në rast të shkeljes së këtyre të drejtave.





LIQJËRATË  
MBI  
MBROJTJEN E  
AMBIENTIT  
NË  
MAMUSHË



MAMUSHË





## LIGJËRATË MBI MBROJTJEN E AMBIENTIT NË MAMUSHË

EC në bashkëpunim më KVRL në Mamushë në bazë të bashkëpunimi të ndërsjelltë kanë shqyrtuar rëndësinë e mbajtjes së një ligjeratë me qëllim të vetëdijesimit të rinjëve për rëndësinë e mbrotjes së ambientit. Ligjerata me temën “Çevre ile ilgili sunum” (ligjërata në lidhje me ambientin) është organizuar në bashkëpunim me KVRL në Mamushë së bashku me nxënësit e shkollës fillore "Anadolu" në mbështetje të EC-it. Në këtë ligjërata kanë qenë prezent nxënësit e shkollës fillore "Anadolu" të grupmoshave të ndryshme para të cilëve ligjëruesi ka prezantuar shkaktarët e ndotjes së ambientit si dhe mënyrat se si të kujdesemi për një ambient më të përshtatshëm. Pas prezantimit nxënësit kanë shprehur ide të ndryshme ku jemi dakorduar që aktivitetin e radhës ta zhvillojmë duke bërë një aksion pastrimi dhe duke shpërndarë fletushka me mesazhe vetëdijesuese për ruajtjen e ambientit.





INTERVENIM  
ARTISTIK NË  
SHKOLLËN "HIVZI  
SYLEJMANI"



FUSHË KOSOVË

## INTERVENIM ARTISTIK NË SHKOLLËN “HIVZI SYLEJMANI”, FUSHË KOSOVË

Nxënësja e Shkollës së Aktivizmit, Vesa Piskala ka ardhur me idenë e krijimit të një ambienti më kreativ në hapësirat e shkollës së saj. Idea konkretisht është realizuar përmes vendosjes së disa hapave të improvizuar në dysheme që të çojnë në drejtim të disa thënieve inspiruese të cilat janë vendosur në hollin e shkollës. Vetë nxënësit e kësaj shkolle, në bashkëpunim me ideatoren e kësaj iniciative, Vesën, si dhe stafin e EC, kanë bërë identifikimin e thënjeve kreative dhe vendosjen e tyre përgjatë një aksioni një ditor. Në këtë mënyrë hollin hyrës i cili shërbente vetëm si hapësirë kaluese, është transformuar në një ambient motivues dhe ftues për nxënësit e kësaj shkolle dhe jo vetëm.





FURNIZIMI I  
SHKOLLËS  
"ALEKSANDËR  
XHUVANI" ME HARTA  
GJEOGRAFIKE DHE  
SISTEME PERIODIKE



PODUJEVË

## FURNIZIMI I SHKOLLËS “ALEKSANDËR XHUVANI” ME HARTA GJEOGRAFIKE DHE SISTEME PERIODIKE, PODUJEVË

Nxënësja e Shkollës së Aktivizmit, Flora Halimi ka shprehur si shqetësim mungesën e disa mjeteve shkollore në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani” në Komunën e Podujevës. Në klasa të këtij gjimnazi janë vendosur Sisteme Periodike, Harta Gjeografike, Harta Memece si dhe Glob. Kjo iniciativë ka pasur si qëllim furnizimin e këtyre nxënësve me këto pajisje duke i konsideruar ato si elemente bazike për zhvillimin e një procesi të rregullt mësimor në një gjimnaz.





FUQIZIMI I GRAVE  
PËRMES NGRITJES  
SË SHKATHTËSIVE  
ARTIZANALE



PRIZREN

## FUQIZIMI I GRAVE PËRMES NGRITJES SË SHKATHTËSIVE ARTIZANALE, PRIZREN

Në kuadër të aktiviteteve të vazhdueshme për mbështetjen e grupeve të nënpërfaqësura EC në bashkëpunim me Roma Versitas Kosova ka filluar trajnimin mbi zhvillimin e shkathtësive artizanale drejt pavarësisë së grave të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas. Në kuadër të këtij trajnimi kanë marrë pjesë 10 gra pjesëmarrëse të cilat nën mentorim të ekspertes janë aftësuar për të krijuar punime dore tradicionale të cilat në fund të këtij cikli të aftësimit do të mund të prezentohen në panairin e punës, duke u dhënë këtyre grave një mundësi më shumë për tu inkuadruar në industrinë e punës.





KRIJIMI I  
DJERRINAVE NË  
RRUGËT E  
QYTETIT



DEJË



## KRIJIMI I PJERRINAVE NË RRUGËT E QYTETIT, PEJË

Në qytetin e Pejës janë realizuar pjerrinat të cilat tani e tutje personave me nevoja të veçanta do t'iu mundësojnë qarkullimin e lirshëm nëpër pikat kyçe të qytetit. Idea për një intervenim të tillë ka ardhur nga nxënësja Flaka Krasniqi gjatë Shkollës së Aktivizimit. Falë këtij aktivizmi janë krijuar 20 pjerrina nëpër pikat të cilat janë identifikuar paraprakisht në bashkëpunim me Handikosin. Këto hapësira nuk kanë qenë në shërbim të personave me nevoja të veçanta, pasi që qarkullimi i tyre nuk ka qenë i mundur pa ndihmën e një personi tjetër. Aplikimi i këtyre pjerrinave ka mundësuar që kjo kategori e marginalizuar e qyteti të Pejës të mund t'i shfrytëzojë këto hapësira njësoj si të gjithë qytetarët e tjerë.





ULËSE PËR  
OBORRIN E  
SHKOLLËS "GJERGJ  
KASTRIOTI -  
SKENDERBEU"



DRENAS



## ULËSE PËR OBORRIN E SHKOLLËS “GJERGJ KASTRIOTI - SKENDERBEU”, DRENAS

Janë vendosur ulëset në oborrin e shkollës "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu" në Drenas, iniciativë kjo e realizuar me propozim të Edorrita Rrukiqi, nxënëse e Shkollës së Aktivizmit. Si në shumë shkolla të tjera të Komunave të ndryshme të Kosovës, edhe në këtë shkollë nxënësit nuk kanë se si t'i shfrytëzojnë hapësirat në ambient të jashtëm, si rezultat i mungesës së ulëseve dhe mobiliarit tjetër përcjellës. Përmes vendosjes së ulëseve, kjo iniciativë ka synuar që pjesërisht të bëjë zgjidhjen e këtij problem, duke u mundësuar nxënësve shfrytëzimin e kësaj hapësire në baza ditore.





RREGULLIMI I  
HAPËSIRËS NË  
SHTËDINE E PLEQVE  
NË FSHATIN  
GURRAKOC



ISTOÇ

## RREGULLIMI I HAPËSIRËS NË SHTËPINE E PLEQVE NË FSHATIN GURRAKOC, ISTOG

Me qëllim të krijimit të një ambienti më të rehatshëm për të moshuarit e Shtëpisë për të Moshuar në fshatin Gurrakoc të Istogut, EC ka intervenuar duke ndërhyrë në kopshtin e kësaj shtëpie. Idea e këtij aktiviteti ka qenë renovimi i ulëseve, shtimi i hapësirave gjelbëruese si dhe vendosja e një pavijoni për hije që ka ardhur si kërkesë nga vetë të moshuarit/banorë të kësaj shtëpie. Të pranishëm kanë qenë edhe z.Mujë Osmanaj- drejtor i drejtoratit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z.Illir Ferati - zyrtar i lartë për planifikim dhe zhvillim të projekteve në Komunën e Istogut si dhe vullnetarët e Komunës së Istogut të cilët kanë kontribuar në përmbushjen e këtij aktiviteti.



[https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/2663783373848352/?epa=SEARCH\\_BOX](https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/2663783373848352/?epa=SEARCH_BOX)





FUNKSIONALIZIM  
I PARKUT "AZIZ  
ZHILIVODA"



OBILIQ

## FUNKSIONALIZIM I PARKUT “AZIZ ZHILIVODA”, OBILIQ

Ngjyrosja e ulëseve, shportave dhe mbjellja e fidaneve në parkun “Aziz Zhilivoda” në Obiliq ka ardhur si ide e Magbule Gashi, nxënëse e Shkollës së Aktivizmit.

Qëllimi i këtij aktiviteti ka përkuar me krijimin e një hapësire më ekologjike përmes shtuarjes së sipërfaqeve gjelbëruese. Poashtu intervenimi është fokusuar edhe në ngjyrosjen e ulëseve dhe vendosjen e shportave, me qëllim të rritjes së kreativitetit dhe funksionalitetit të hapësirës në fjalë. Kontribues të këtij aktiviteti ishin Zyrtarë për Mbrojtjen e Mjedisit, vullnetarë të Qendrës Rinore në Obiliq, përfaqësues të Kryqit të Kuq Obiliq, përfaqësues të KVRL-së dhe qytetarë të Obiliqit.





RENOVIM I  
OBORRIT TË  
SHKOLLËS NË  
BLINAJË



LIPJAN





## RENOVIM I OBORRIT TË SHKOLLËS NË BLINAJË, LIPJAN

Nxënësja e Shkollës së Aktivizmit Samire Qadraku, ka identifikuar si shqetësim të përgjithshëm të nxënësve të shkollës "Haradin Bajrami" në fshatin Blinajë të Komunës së Lipjanit mungesën e ulëseve dhe të hapësirave të dedikuara për hudhjen e mbeturinave. Kjo iniciativë ka pasur si qëllim vënien në funksion dhe shfrytëzimin e kësaj hapësire nga nxënësit e kësaj shkolle. Po ashtu ide e nxënëses ka qenë edhe ngjyrosja e rrethojave të shkollës me qëllim të krijimit të një hapësire rekreative.

Për realizimin e kësaj ideje nxënësit kanë punuar vullnetarisht në bashkëpunim me mësimdhënësit dhe stafin teknik të shkollës.



[https://www.facebook.com/ecmandryshe/  
videos/350564422528556/?epa=SEARCH\\_BOX](https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/350564422528556/?epa=SEARCH_BOX)





"TROTUARE  
TË QASSHME  
PËR TË  
GJITHË"



GJAKOVË



## “TROTUARE TË QASSHME PËR TË GJITHË”, GJAKOVË

EC në bashkëpunim me Hendikosin dhe KVRL në Gjakovë, kanë realizuar performancën publike “Trotuare të qasshme për të gjithë”, përmes të cilit aktivitet kanë reaguar ndaj neglizhencës dhe pasivitetit të autoriteteve komunale në ndërmarrjen e masave adekuate për sigurimin e lëvizjes së lirë në trotuares dhe rrugët kryesore të qytetit të Gjakovës për Personat me Aftësi të Kufizuara.



Përmes këtij aktiviteti, në mënyrë simbolike përkatësisht duke bërë intervenime direkte në një pjesë të trotuareve në rrugën “UÇK” është theksuar e drejta e PAK-ve për qasje dhe lëvizje të lirë dhe më të sigurt brenda zonës urbane. Poashtu u është bërë thirrje institucioneve përgjegjëse për t'u angazhuar më shumë duke i ofruar prioritet çështjes së eliminimit të pengesave dhe krijimit të kushteve për këtë kategori të komunitetit.





TRYEZË  
DISKUTIMI  
"HUMANIZMI  
DHE  
VULLNETARIZIMI"



LIPJAN

## TRYEZË DISKUTIMI “HUMANIZMI DHE VULLNETARIZIMI”, LIPJAN

Ky aktivitet ka përkuar me realizimin e tryezës së diskutimit me temë “Humanizmi dhe vullnetarizimi”, organizuar nga nxënësi i Shkollës së Aktivizmit Rinor Murati me mbështetje të EC-it. Rinor Murati, i cili poashtu është pjesë e organizatës rinore “Hope” ka ardhur me idenë se një temë e tillë është e nevojshme për tu diskutuar në komunitet. Në këtë diskutim kanë qenë 30 pjesëmarrës para të cilëve panelistët kanë prezantuar format e vullnetarizimit dhe përfitimet nga aktivitetet e tilla. Panelistë të këtij diskutimi ishin z. Murat Murati, znj. Lorentë Kadriu, z. Artan Maliqi të cilët së bashku me pjesëmarrësit diskutuan rreth aktivizmit rinor në komunën e Lipjanit dhe në Kosovë në tërësi.





HAPËSIRA  
ÇJELBËRUESE NË  
OBORRIN E  
SHKOLLËS "BAHRI  
HAXHA"



VUSHTRRI



## HAPËSIRA GJELBËRUESE NË OBORRIN E SHKOLLËS "BAHRI HAXHA", VUSHTRRI

Nxënësi i Shkollës së Aktivizmit, Bleart Hamdiu si shqetësim për nxënësit e shkollës së tij ka potencuar mungesën e hapësirës së gjelbër në oborrin e shkollës "Bahri Haxha" në Vushtrri. Me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi dhe njëkohësisht zbutjes së nivelit të ndotjes së mjedisit, nxënësi ka ardhur me idenë e mbjelljes së fidaneve në oborrin e kësaj hapësire.



Në realizimin e këtij aktiviteti janë përfshirë nxënësit dhe menaxhmenti i shkollës, duke kontribuar në mbjelljen e fidanëve. EC ka mbështetur këtë iniciativë duke trajtuar mungesën e hapësirave të gjelbra përmes inkuadrimit të komunitetit në këtë intervenim.





DARKINGJE PËR  
BIÇIKLETA



FERIZAJ






## **PARKINGJE PËR BIÇIKLETA, FERIZAJ**

Grupi "Rinia (pa) Qendër" i themeluar në kuadër të Shkollës së Aktivizmit ka realizuar një aktivitet gjatë së cilit janë vendosur parkingje të biçikletave në shkollat "Arsim Rexhepi", "Riza Matoshi" dhe "Ramadan Rexhepi" të komunës së Ferizajit.



Qëllimi i vendosjes së këtyre parkingjeve është promovimi më i madh i mbrojtjes së ambientit përmes reduktimit të ndotjes nga ana e përdorimit të automjeteve dhe të përdorimit të biçikletave. Ky grup ka parë të nevojshme që këto parkingje të vendosen në këto shkolla duke qenë se kjo është shfaqur si nevojë nga vetë nxënësit e shumë përdorues të biçikletave.





MARKIMI I  
SHTIGJEVE TË ECJES  
NË PARKUN  
MORONICA NË  
JUNIK



JUNIK


## MARKIMI I SHTIGJEVE TË ECJES NË PARKUN MORONICA NË JUNIK

Praktika e markimit të shtigjeve në zona rekreative malore ka ardhur si propozim që të aplikohet në parkun Moronica nga Vjollca Qestaj, nxënëse e Shkollës së Aktivizmit. Këto shenjzime saktësisht përcaktojnë drejtimin e ecjes dhe distancën duke shërbyer si udhërrëfyes për vizitorët e këtij parku. Ky aktivitet është realizuar me qëllim që të promovohet të turizmi malor në këtë pjesë të Junikut.



[https://www.facebook.com/ecmandryshe/  
videos/520426095362119/?epa=SEARCH\\_BOX](https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/520426095362119/?epa=SEARCH_BOX)





LUXEMBOURG  
AID & DEVELOPMENT



EC  
EUROPEAN COMMISSION

KCSF  
KOSOVAN CIVIL SOCIETY FORUM

01

### A.R.I

**Simptomat:**

1. Temperaturë e lartë,
2. Kollitje,
3. Dhimbje Koke.

**Parandalimi:**

1. Vaksina,
2. Barnat antivirale

02

### DIAREA ACUTE

**Simptomat:**

1. Dhimbje barku,
2. Fryerje barku,
3. Gjak në feçe.

**Parandalimi:**

1. Mosdehidrimi,
2. Mospërdorimi i qumështit,
3. Mospërdorimi i ushqimeve të pa gatuar ose të gatuar pak.



BROSHURA  
INFORMUESE  
MBI  
SËMUNDJET  
MË TË  
PËRHAPURA




LIPJAN

## BROSHURA INFORMUESE MBI SËMUNDJET MË TË PËRHAPURA, LIPJAN

Nxënësja e Shkollës së Aktivizmit, Festina Duhlaku me qëllim të informimit të qytetarëve të Lipjanit, ka propozuar përpilimin e disa broshurave informuese për sëmundjet më të përhapura në këtë komunë. Broshurat kanë për qëllim që të rrisin vëmendjen dhe mbështetjen për sensibilizimin, zbulimin e hershëm, trajtimin, si dhe kujdesin për këto sëmundje.

Në këto broshura përveç simptomave të sëmundjeve, është përfshirë edhe numri i personave të prekur për periudhat kohore janar - dhjetor 2018 dhe janar- prill 2019, statistika këto të dalura nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Lipjan.





KUTI PËR  
GRUMBULLIMIN E  
ANKESAVE NGA  
NXËNËSIT



DEÇAN & KAÇANIK

## AKTESAT DHE SYGJERIMET

### AKTESAT DHE SYGJERIMET

Kutia e ankesave dhe sygjerimeve është vendosur me iniciativë të grupit "Të drejtat e Njeriut", pjesëmarrës në Shkollën për Aktvizimin e të Rinjve për Aktvizim në Komunitet.



Kjo iniciativë është realizuar në kuadër të projektit Akt Ruziti (si Ankesat dhe Sygjerimet) nga projekti "Ndërkrahja e Luksemburgut dhe mësuesit rrethorë të rinjve" (Luk 2021).

### AKTESAT DHE SYGJERIMET

Kutia e ankesave dhe sygjerimeve është vendosur me iniciativë të grupit "Të drejtat e Njeriut", pjesëmarrës në Shkollën për Aktvizimin e të Rinjve për Aktvizim në Komunitet.



Kjo iniciativë është realizuar në kuadër të projektit Akt Ruziti (si Ankesat dhe Sygjerimet) nga projekti "Ndërkrahja e Luksemburgut dhe mësuesit rrethorë të rinjve" (Luk 2021).

Nxënësit e Shkollës së Aktivizimit si shqetësim e kanë shfaqur mungesën e mekanizmave që kërkesat, nevojat dhe shqetësimet e tyre t'i shprehin drejt stafit menaxhues dhe kanë ardhur me propozimin që në ambientet e caktuara t'i vendosin disa kuti për grumbullimin e ankesave. Sipas tyre, këto kuti do t'u mundësojnë nxënësve që në mënyrë anonime t'i paraqesin çështjet e tyre, dhe në këtë formë do të rritet edhe aktivizmi i tyre për të adresuar kërkesat apo nevojat me të cilat ballafaqohen.

Idea për realizimin e këtyre iniciativave ka ardhur nga Altina Xhini - Kaçanik dhe Grupi "Të drejtat e njeriut" nga Deçani. Kutitë e ankesave janë vendosur në Shkollën Fillore „Lidhja e Prizrenit“- Deçan, QKMF “Adem Ukëhaxhaj” - Deçan, në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" - Deçan dhe në Shkollën Profesionale "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik.





INTERVENIM  
ME NGJYRA  
NË HAPËSIRË  
PUBLIKE



HAN I ELEZIT






## INTERVENIM ME NGJYRA NË HAPËSIRË PUBLIKE, HAN I ELEZIT

Nxënësja e Shkollës së Aktivizmit, Natyra Kalisi, me qëllim të krijimit të një hapësire më të këndshme dhe rekreative për qytetin e saj ka propozuar që të intervenohet në parkun e Komunës së Hanit të Elezit. Meqenëse kjo hapësirë publike është identifikuar si një pjesë që frekuentohet shumë nga banorët, nxënësja Natyra ka ideuar iniciativën në fjalë përmes sjelljes së ngjyrave në këtë park, duke lyer ulëset, shportat dhe rrethojat e fidaneve.





DHURIM I TITUJVE  
PËR LEXUESIT E  
SHKOLLËS  
FILLORE "IDRIZ  
SEFERI"



KAÇANIK

## DHURIM I TITUJVE PËR LEXUESIT E SHKOLLËS FILLORE “IDRIZ SEFERI”, KAÇANIK

Nxënësja e Shkollës së Aktivizmit, Rinora Dema, si shqetësim ka shfaqur mungesën e librave dhe inventarit të bibliotekës për shkollën “Idriz Seferi” që gjendet në vendbanimin e saj. EC në bashkëpunim me nxënësen që ka propozuar këtë iniciativë ka hapur thirrjen për dhurim të librave, me ç’rast në bashkëpunim me shkollën janë mbledhur 403 tituj të cilët janë akomoduar në një raft të realizuar me mbështetjen e EC.





"BASKETSHISHE" SI  
NJË FORMË  
KREATIVE PËR  
RICIKLININ E  
PLASTIKËS



LIPJAN



## “BASKETSHISHE” SI NJË FORMË KREATIVE PËR RICIKLIMIN E PLASTIKËS, LIPJAN

BasketShishet është një iniciativë atraktive e realizuar në shkollat fillore "Vëllezërit Frashëri" dhe "Ismail Luma" në Lipjan dhe si ide ka dalur nga Diellza Krasniqi nxënëse e Shkollës së Aktivizmit.



Duke qenë se në ditët e sotme mbetjet e plastikës janë duke krijuar një ndikim të madh negativ në mjedisin natyror, atëhere nxënësja e Shkollës së Aktivizmit e ka menduar promovimin e riciklimit për të ngritur vetëdijen rreth këtij problemi ambiental. Në kuadër të kësaj iniciative, në dy shkollat e lartpërmendura janë vendosur shporta që do të shërbejnë për grumbullimin e plastikës. Për ta bërë këtë iniciativë më tërheqëse tek nxënësit, në shportat e plastikës janë vendosur kosha të basketbollit nga ku mund të hidhen shishet e tilla. Kjo ide është zgjeruar me një bashkëpunim me kompaninë "Pastrimi", të cilët në baza të caktuara kohore do të grumbullojnë plastikën dhe paratë e grumbulluara do të investohen në mbjelljen e fidaneve, me ç'rast nxënësit do të kontribuojnë në një ambient më të gjelbër dhe më të pastër.





DASURIMI I  
BIBLIOTEKËS DHE  
VENDOSJA E RAFTIT  
NË SHKOLLËN  
"NAZMI PAJAZITI"



VITI



## **PASURIMI I BIBLIOTEKËS DHE VENDOSJA E RAFTIT NË SHKOLLËN “NAZMI PAJAZITI”, VITI**

Nevoja për pasurimin e bibliotekave me libra dhe me inventarin e nevojshëm është shfaqur si shqetësim edhe prej nxënësve të Shkollës së Aktivizmit nga komuna e Vitisë. Duke qenë se bibliotekave të shkollave ende i'u mungojnë kushtet bazike atëherë nxënësi Jon Devaja ka ardhur me idenë që në shkollën “Nazmi Pajaziti” në Radivojc të intervenohet duke sjellur një raft për mbajtjen e librave dhe pasurimin e saj me tituj të nevojshëm për gjeneratat që vijojnë mësimet aty. Për grumbullimin e këtyre librave është hapur një thirrje disa javore në kuadër të së cilës janë grumbulluar një numër i konsiderueshëm titujsh.





VARËSE PËR  
GJIMNAZIN  
"ZENEL  
HAJDINI"




GJILAN



## VARËSE PËR GJIMNAZIN “ZENEL HAJDINI”, GJILAN

Në klasat e Gjimnazit "Zenel Hajdini" në Gjilan janë vendosur 25 varëse, iniciativë kjo e realizuar me propozim të Blend Behlulit, nxënës i Shkollës së Aktivizmit. Një intervenim i tillë është parë i nevojshëm nga nxënësi në fjalë, duke konsideruar se këto varëse përbëjnë elementet bazë të cilat duhet t'i ketë secila shkollë në kuadër të komunës së tij.

Ky intervenim simbolik ka shërbyer në eliminimin e një mungese me të cilën shkolla “Zenel Hajdini” ballafaqohet, dhe njëherit në fuqizimin e të rinjëve drejt identifikimit dhe eliminimit të mangësive në komunitetin e tyre.





ULËSE PËR  
NXËNËSIT E  
QENDRËS SË  
KOMPETENCËS



FERIZAJ

## ULËSE PËR NXËNËSIT E QENDRËS SË KOMPETENCËS, FERIZAJ

Janë vendosur ulëset në oborrin e Qendrës së Kompetencës në Ferizaj, iniciativë kjo e realizuar me propozim të Samir Selmani, nxënës i Shkollës së Aktivizmit Kjo iniciativë ka pasur qëllimin e vënies në funksion dhe shfrytëzimit të kësaj hapësire nga nxënësit e kësaj Qendre. Si në shumë shkolla të tjera të Komunave të ndryshme të Kosovës, mungesa e mobiliarit urban në kuadër të oborreve shkollore ka dalë të jetë një prej kërkesave më të shprehura të nxënësve vijues të mësimi.





MURALE NË  
PARKUN E  
MORONICËS



JUNIK

## MURALE NË PARKUN E MORONICËS, JUNIK

Në Junik është realizuar iniciativa e radhës e cila si propozim ka dalur nga Dardane Shala nxënëse e Shkollës së Aktivizmit. Idea e kësaj iniciative ishte realizimi i muraleve në murin e Moronicës me qëllim të përmirësimit estetik dhe shtimit të atraktivitetit të kësaj zone.

Të rinjtë e Junikut kanë punuar vullnetarisht dy ditë për realizimin e kësaj iniciative nën mentorimin e Blerina Sallaj dhe Sindije Idrizi, duke ftuar kështu edhe të rinjë e tjerë që të vazhdojnë me realizimin e punimeve të tilla.





DHURIM I  
LIBRAVE PËR  
SHKOLLËN  
"FEHMI  
AGANI"



KLINË

## DHURIMI I LIBRAVE PËR SHKOLLËN “FEHMI AGANI”, KLINË

Me propozim të nxënëses Rinesa Gashi, pjesëmarrëse në Shkollën e Aktivizmit, është realizuar iniciativa për pasurimin e bibliotekës së shkollës “Fehmi Agani” në Klinë. EC ka përkrahur qëllimin fillestar të nxënëses Rina, duke u angazhuar në hapjen e thirrjes publike për dhurimin e librave të cilët do të jenë në shfrytëzim të shkollës “Fehmi Agani”. Gjatë thirrjes së hapur për dhurimin e librave, është arritur që të grumbullohen 300 tituj të fushave të ndryshme nga të cilat 120 janë dhuruar nga EC Ma Ndryshe. EC me këtë rast ka falënderuar qytetarët për kontributin e tyre me fondin e dhuruar të titujve dhe ka ftuar të tjerët që të zgjerojnë këtë bibliotekë përmes dhurimit të librave tjerë.





VENDOSJA E  
SHPORTAVE TË  
MBETURINAVE NË  
SHESHIN "FARUK  
ELEZI"



KLINË





## VENDOSJA E SHPORTAVE TË MBETURINAVE NË SHESHIN “FARUK ELEZI”, KLINË

Përmes kësaj iniciative është bërë vendosja e 10 shportave për hudhjen e mbeturinave në sheshin “Faruk Elezi” në Klinë. Meqenëse ka pasur mungesë të dukshme të hapësirave të dedikuara për hudhjen e mbeturinave në këtë hapësirë, është parë e nevojshme që të bëhet vendosja e këtyre shportave, aktivitet që u mirëprit nga banorët dhe institucionet. Kjo iniciativë ka dalur si ide e Ernis Salihut, pjesëmarrës i Shkollës për Aftësimin e të Rinjve për Aktivizim në Komunitet. I pranishëm në realizimin e aktivitetit ishte edhe drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjente të Klinës, z. Iber Elezaj, i cili falënderoi realizuesit dhe u tregua i gatshëm për bashkëpunim, për të vazhduar kështu me mirëmbajtjen e këtyre shportave përmes kompanisë përgjegjëse. EC me këtë rast ka bërë thirrje te qytetarët e Klinës që të jenë të kujdesshëm në hudhjen e mbeturinave në hapësirat e dedikuara për to, në mënyrë që të parandalohet ndotja e mëtutjeshme e ambientit.



[https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/2055412317900906/?epa=SEARCH\\_BOX](https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/2055412317900906/?epa=SEARCH_BOX)



"ÇELËSI I  
SIGURISË ËSHTË  
NË DUART E  
TUA"



PEJË



## “ÇELËSI I SIGURISË ËSHTË NË DUART E TUA”, PEJË

Në qytetin e Pejës është realizuar kampanja vetëdijesuese e cila ka synuar të shërbejë si thirrje për shtim të kujdesit në trafik dhe mënjanim të aksidenteve, ide kjo e nisur dhe realizuar nga të rinjtë e komunës së Pejës, pjesëmarrës të Shkollës së Aktivizmit. Si shqetësim për nxënësit ka dalur pasiguria e madhe në trafik dhe numri i madh i aksidenteve, prandaj për këtë arsye këta pjesëmarrës kanë vendosur që të fillojnë një aksion i cili tenton të shtojë vëmendjen tek çështja e sigurisë në komunikacion.



Të rinjtë e Pejës dhe stafi i EC në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Qendrën Rinore Inovative të Pejës në kuadër të kësaj iniciative kanë bërë shpërndarjen e fletushkave nëpër qendër të këtij qyteti, me statistikat e aksidenteve të vitit 2018 duke përfshirë të gjitha komunat e Kosovës si dhe sloganet “Vozitja jote e shpejtë mund të jetë vozitja jote e fundit” dhe “Aksidentet nuk ndodhin aksidentalisht”. Ky aktivitet njëkohësisht shërben edhe si një thirrje ndaj institucioneve që të vazhdojnë të ndër marrin hapa konkret në shtimin e sigurisë në komunikacion.





AKTIVITET  
BAMIRËS  
"ZBUTE DIMRIN  
PAK"



PEJË



## AKTIVITET BAMIRËS “ZBUTE DIMRIN PAK”, PEJË

Është realizuar iniciativa “Zbute dimrin pak” e cila si propozim ka dalur nga Leonita Krasniqi, nxënëse e Shkollës së Aktivizmit. Aksioni për grumbullimin e veshmbathjeve për personat në nevojë është zhvilluar në partneritet me OJQ "Syri i vizionit" dhe Qendra Rinore Inovative ku edhe është bërë mbledhja e veshmbathjeve. Grumbullimi i veshmbathjeve ka vazhduar edhe përmes një aktiviteti public në Sheshin përballë Komunës së Pejës, nga ku pastaj është bërë edhe shpërndarja e tyre. Qytetarët kanë përqafuar këtë ide për tu dalur në ndihmë personave në nevojë, ndërsa shpërndarja e veshëmbathjeve është asistuar nga UNICEF.



Përmes kësaj iniciative, të rinjtë pjesëmarrës të Shkollës së Aktivizmit kanë dëshmuar se janë të gatshëm të solidarizohen me të gjitha grupet e komunitetit.





ZEBRA  
SHUMËNGJYRËSHE



PRIZREN

## ZEBRA SHUMËNGJYRËSHE, PRIZREN

Qëllimi i kësaj performance publike është shtimi i vëmendjes për sigurinë në trafik, ashtu që ngasësit e automjeteve dhe këmbësorët të respektojnë shenjat e komunikacionit. Ndër rrugët më të frekuentuara nga nxënësit dhe automjetet në qytetin e Prizrenit janë ato në afërsi të Shkollave fillore dhe të mesme të ulëta "Mustafa Baku" dhe "Emin Duraku" si dhe shkollës së mesme "Remzi Ademaj". Për këtë arsye pranë këtyre shkollave zebraat janë dizajnuar në atë mënyrë që t'i nxisin këmbësorët e posaçërisht fëmijët që ta kalojnë rrugën në vendkalimin e paraparë, derisa për ngasësit janë ngjyrat më të ndritshme dhe të dallueshme për t'i paralajmëruar ata që të shtojnë kujdesin gjatë vozitjes në këto zona.

Përmes realizimit të kësaj iniciative, EC ka bërë thirrje tek të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, që t'i respektojnë shenjat e komunikacionit dhe të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që të mos rrezikojnë jetën e askujt.





"ZEBRA  
SHUMËNGJYRËSHE",  
NË FSHATIN  
DUBRAVË & VRELLË



ISTOÇ



## “ZEBRA SHUMËNGJYRËSHE”, NË FSHATIN DUBRAVË & VRELLË, ISTOG

Pas pëlqimit të dukshëm dhe përkrahjes së madhe për ndërhyrjet e EC-it në vendkalimet për këmbësorë përpara shkollave nëpër qytetin e Prizrenit, me qëllim të shtimit të vëmendjes së vozitësve dhe tërheqjes së nxënësve për të kaluar nëpër to, janë adresuar kërkesa të shumta për vazhdimin e ndërhyrjeve të tilla edhe në qytetet e tjera.

Anisa Bicaj dhe Egzon Behlulaj, nxënës të Shkollës së Aktivizmit, kanë shprehur nevojën për një intervenim të tillë përpara shkollave të fshatrave të tyre dhe kanë protokoluar kërkesat tek institucionet përkatëse për të marrë leje për realizimin e kësaj iniciative. Rrjedhimisht, zebraat shumëngjyrëshe janë punuar së bashku me nxënësit në fshatin Vrellë (përpara shkollës “Hysni Zajmi”) dhe Dubravë (përpara shkollës “Bajram Curri”) të komunës së Istogut.





"PARK PËR TË  
GJITHË", VIZIONIMI  
I HAPËSIRËS SË  
SHKOLLËS "SADRI  
DUHLA"



SUHAREKË



## **“PARK PËR TË GJITHË”, VIZIONIMI I HAPËSIRËS SË SHKOLLËS “SADRI DUHLA”, SUHAREKË**

Kjo nismë konsiston në realizimin e vizionimit “Parkut për të gjithë” në shërbim të shkollës “Sadri Duhla” në fshatin Duhël të Komunës së Suharekës. Propozimi për intervenimin në këtë hapësirë ka ardhur nga Krenare Qatani nxënëse e Shkollës së Aktivizmit e cila ka sugjeruar që hapësira brenda kësaj shkolle të shndërrohet në një zonë të përshtatshme dhe të shfrytëzueshme nga të gjitha kategoritë e komunitetit, duke qenë se në këtë fshat ka mungesë të madhe të hapësirave rekreative. Këtij vizionimi i ka paraprirë edhe një punëtori ku ekspertët e angazhuar nga EC janë takuar me banorët për të marrë propozimet e tyre për vizionimin e këtij parku. Në takim të mbajtur me drejtorin e kësaj shkolle është bërë edhe prezantimi i vizionimit final. Ky projekt i është dorëzuar poashtu institucioneve lokale duke bërë thirrje për implementimin e tij.





SHFAQJA E  
DOKUMENTARIT  
"UDHËTIMI VIRTUAL  
NË MONUMENTET E  
TRASHËGIMISË  
KULTURORE"



MALISHEVË



## SHFAQJA E DOKUMENTARIT “UDHËTIMI VIRTUAL NË MONUMENTET E TRASHËGIMISË KULTURORE”, KIJEVË

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes tek të rinjtë mbi vlerat e trashëgimisë kulturore dhe përcjelljes së mesazhit tek institucionet që të ndërmarrin hapa në drejtim të mbrojtjes së objekteve të vjetra të trashëgimisë të cilat janë të rrezikuara, është realizuar iniciativa "Udhëtim virtual në monumentet e trashëgimisë kulturore". Kjo iniciativë është nisur nga Gresë Toplana nxënëse e Shkollës së Aktivizmit në përpjekje të mbrojtjes së ish-objektit të teatrit të fshatit të saj në Kijevë dhe rikthimit të tij në shfrytëzim të qytetarëve.



Në kuadër të këtij aktiviteti është shfaqur një dokumentar me përmbajtje informative rreth objekteve kulturore të rrezikuara si dhe është diskutuar së bashku me pjesëmarrësit se si me anë të aktivizmit mund të arrihet mbrojtja dhe rifunksionalizimi i këtyre monumenteve. Aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me vullnetarët dhe stafin e Qendrës Rinore në Malishevë.



SAY NO TO BULLYING

EC  
NA-ARRESTAT

ecmandryshe.org

AktRural

Aktivizmi i të rinjve në  
zonat rurale të Kosovës

LIQJËRATË  
"PËRJASHTIMI  
SOCIAL NË  
SHKOLLA"



PRIZREN

## LIGJËRATË “PËRJASHTIMI SOCIAL NË SHKOLLË”, PRIZREN

E ideuar nga nxënësja e Shkollës së Aktivizmit, Era Dakaj, është realizuar iniciativa "Përrjashtimi social në shkollë". Në kuadër të këtij aktiviteti është shfaqur filmi “Përtej vijave” në shkollën fillore “Emin Duraku” i cili përmban një tematikë mbi parandalimin e ngacmimeve në shkollë. Pas shfaqjes së filmit është mbajtur një diskutim i hapur ku pjesëmarrësit kanë dhënë përshtypjet e tyre mbi filmin e shfaqur e ideatorja ka dhënë detaje si ka ardhur deri tek kjo ide dhe si duhet trajtuar ky fenomen negativ.

Kjo iniciativë është realizuar në bashkëpunim me nxënësit dhe stafin e shkollës “Emin Duraku” në Prizren si dhe ekipin realizues të filmit “Përtej vijave”.





TRANSPORT  
FALAS PËR  
VULLNETARË TË  
QENDRËS  
RINORE



RAHOVEC





## TRANSPORT FALAS PËR VULLNETARË TË QENDRËS RINORE, RAHOVEC

Bleona Morina, nxënëse e Shkollës së Aktivizmit ka ideuar këtë iniciativë duke u thirrur në premtimin e kryetarit të Rahovecit gjatë fushatës elektorale. Nxënësjja në fjalë ka kërkuar llogaridhënje nga kryetari i Komunës mbi premtimin e dhënë për lirimin e vullnetarëve të Qendrës Rinore “SHL-Kosova” nga shpenzimet për të frekuentuar këtë qendër.



Rrjedhimisht kjo iniciativë ka përkuar me dorëzimin e listës me emra të vullnetarëve të cilët do të kenë transport falas deri në Qendrën Rinore të Komunës së Rahovecit. Vullnetarët e Qendrës Rinore “SHL-Kosova” në bashkëpunim me EC-in kanë drejtuar tek kryetari z.Smajl Latifi këtë kërkesë e cila ka marrë përgjigje pozitive dhe janë kërkuar të dhënat e vullnetarëve dhe informacionet e tjera të nevojshme për të filluar me procedurat.





VENDOSJA E KËNDIT  
TË LIBRAVE  
"LEXIMTARËT E  
RINJ"



KABASH I HASIT

## VENDOSJA E KËNDIT TË LIBRAVE “LEXIMTARËT E RINJ”, KABASH I HASIT

“Leximtarët e rinj” është iniciativë e propozuar nga nxënësja e “Shkollës për aftësimin e të rinjve për aktivizëm në komunitet”, Drenushë Morina e cila ka identifikuar si tëjet të nevojshme ekzistimin e një biblioteke në kuadër të shkollës së saj.

EC me qëllim të realizimit të iniciativës “Leximtarët e rinj” ka hapur një thirrje disa javore për dhurimin e librave të rinj dhe të përdorur. Gjatë thirrjes së hapur për dhurimin e librave, qytetarët me vullnetin e tyre për të pasuruar bibliotekën e shkollës “Dëshmorët e Hasit” në Kabash kanë arritur të grumbullojnë 253 tituj të fushave të ndryshme. Në ndërkohë gjatë grumbullimit të librave është dizajnuar edhe rafti i kësaj biblioteke i cili është vendosur në këtë shkollë dhe është në dispozicion për shfrytëzim.





VENDOSJA E  
ULËSEVE PËR  
BANORËT E  
FSHATIT  
GLOBOÇICË



DRAGASH



## VENDOSJA E ULËSEVE PËR BANORËT E FSHATIT GLOBOÇICË, DRAGASH

Me propozim të Damir Haljilji dhe Asmir Abdi, nxënës të Shkollës së Aktivizmit, janë vendosur ulëset në rrugën që lidh fshatrat Globoçicë dhe Krushevë, iniciativë kjo e dalur gjatë ciklit të edukimit mbi aktivizmin.

Më herët në këtë rrugë kanë qenë të vendosura ulëse për pushim por ato janë dëmtuar dhe nuk ekzistojnë më. Prandaj për këto dy fshatra është vlerësuar se është shumë e nevojshme vendosja e ulëseve pasi që banorët që lëvizin nga fshati në fshat kanë nevojë të ulen dhe të pushojnë gjatë rrugëtimit.





RIFUNKSIONALIZIMI  
I SHTËDISË SË  
KULTURËS



MAMUSHË



## RIFUNKSIONALIZIMI I SHTËPISË SË KULTURËS, MAMUSHË

Është realizuar iniciativa “Rifunksionalizimi i Shtëpisë së Kulturës” në Mamushë. Kërkesa për futjen në funksion të kësaj ndërtese ka ardhur nga nxënësit e “Shkollës për aftësimin e të rinjve për aktivizëm në komunitet”, të cilët janë shprehur të shqetësuar për gjendjen aktuale të këtij objekti, i cili edhe pse i ndërtuar nga paratë publike, nuk është në shërbim të komunitetit. Për më tepër objekti në fjalë paraqet kanosje për banorët e Mamushës, duke qenë se është lënë pa mirëmbajtje dhe në funksion të grumbullimit të mbeturinave.



Në bashkëpunim me Komunën e Mamushës, EC ka bërë pastrimin e ndërtesës dhe funksionalizimin periodik të saj, në shërbim të komunitetit. Rrjedhimisht, në kuadër të kësaj iniciative është bërë shfaqja e një filmi për banorët e këtij vendbanimi.





KAMPANJË  
VETËDIJESUES  
E PËR KUJDES  
GJATË  
VOZITJES



GJAKOVË





## KAMPANJË VETËDIJESUESE PËR KUJDES GJATË VOZITJES, GJAKOVË

Në Gjakovë është realizuar kampanja vetëdijesuese kundër përdorimit të telefonave gjatë vozitjes e cila ka shërbyer si thirrje për ngasësit e automjeteve që të kenë kujdes të shtuar gjatë vozitjes. Nevoja për realizimin e kësaj iniciative ka buruar nga nxënësit pjesëmarrës në Shkollën e Aktivizmit, ku gjatë diskutimeve ka dalë si shqetësim përdorimi i telefonave gjatë vozitjes nga ana e ngasësve, duke cënuar në këtë mënyrë sigurinë në trafik. Më konkretisht, nxënësja Kleita Koci ka ardhur me propozimin e kësaj kampanje me qëllim të thirrjes për kujdes të shtuar gjatë vozitjes.



Ky aktivitet është organizuar në bashkëpunim me KVRL- Gjakovë dhe qytetarët e qytetit të Gjakovës, me ç'rast është bërë shpërndarja e fletushkave që përmbajnë mesazhe sensibilizuese dhe statistika të aksidenteve që kanë ndodhur që nga viti 2017 në rajonin e Gjakovës dhe në tërë Kosovën.





REALIZIMI I  
MURALIT NË  
PASAZHIN "NËNË  
TEREZA"



GJAKOVË



## REALIZIMI I MURALIT NË PASAZHIN “NËNË TEREZA”, GJAKOVË

Duke marrë një pamje tërësisht të re, është realizuar murali në pasazhin që gjendet në rrugën “Nëna Terezë” në Gjakovë. Autorja e idesë për këtë intervenim artistik Era Skivjani, nxënëse e “Shkollës për aftësimin e të rinjve për aktivizëm në komunitet”, ka inicuar këtë iniciativë duke u nisur nga fakti që ky pasazh edhe pse shfrytëzohet vazhdimisht nga banorët e lagjes, dhe qytetarët në përgjithsi, vazhdon të jetë i pa mirëmbajtur. Dizajni shumëngjyrësh i aplikuar e ka kthyer këtë hapësirë në një ambient ftues për banorët e lagjes, dhe njëherit ka rritur sigurinë e lëvizjes. Rëndësia e kësaj initiative qëndron në faktin se është realizuar nga vetë autorët e iniciativës dhe të rinjtë tjerë nga qyteti i Gjakovës, përkrahës të kësaj ideje.





"NJË KAFE ME  
TRASHËGIMINË"



PRIZREN



## “NJË KAFE ME TRASHËGIMINË”, PRIZREN

Në oborrin e shtëpisë së Familjes “Kirajtani” që gjendet në rrugën “Shuaip Spahiu”, në Prizren, EC ka organizuar një aktivitet ku janë shërbyer pije dhe ëmbëlsira për vizitorët. Shndërrimi një-ditor i kësaj shtëpie në një hapësirë si “kafeteri” është realizuar me qëllim që të përcillet mesazhi se objektet me vlera të tilla mund të kthehen në destinacione të ndryshme turistike dhe nxitëse të zhvillimit ekonomik njëkohësisht, nga ku të ardhurat do të përmirësonin gjendjen, do të rrisnin vetë-qëndrueshmërinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së vlerave të ndërtesave të tilla. Ushqimi dhe pijet tradicionale janë përgatitur nga zonja e shtëpisë e cila njëkohësisht ka luajtur rolin e ciceronit gjatë ardhjes së vizitorëve.

EC përmes kësaj iniciative edhe njëherë ka avokuar për shfrytëzimin e potencialit të trashëgimisë kulturore dhe krijimit të vetëqëndrueshmërisë.



[https://www.facebook.com/ecmandryshe/  
videos/2300853013501508/?epa=SEARCH\\_BOX](https://www.facebook.com/ecmandryshe/videos/2300853013501508/?epa=SEARCH_BOX)

4

HARTA E  
INICIATIVAVE

## **LISTA E INICIATIVAVE TË REALIZUARA**

- 1.** Shporta dhe ulëse për shkollën fillore “Ibrahim Fehmiu”, Prizren
- 2.** Ulëse për shkollën “Nefit Jusufi”, Skorobisht – Prizren
- 3.** Transport falas për vullnetarë të Qendrës Rinore, Rahovec
- 4.** Kërkesë dhe peticion për zhvendosjen e shtyllave elektrike, Skorobisht - Prizren
- 5.** Kërkesë për vendosjen e shportave për mbeturina në fshatin Mazrek - Prizren
- 6.** Realizimi i muralit në pasazhin “Nënë Tereza”, Gjakovë
- 7.** “Park për të gjithë”, vizionimi i hapësirës së shkollës “Sadri Duhla”, Suharekë
- 8.** Shpërndarja e torbave ekologjike për reduktimin e qeseve të plastikës, Prizren
- 9.** Vendosja e shportave për një mjedis pa mbeturina, Ferizaj
- 10.** Vendosja e shportave të mbeturinave në sheshin “Faruk Elezi”, Klinë
- 11.** Hapësira gjelbëruese në oborrin e shkollës “Bahri Haxha”, Vushtrri
- 12.** “BasketShishe” si një formë kreative për riciklimin e plastikës, Lipjan
- 13.** Broshura informuese mbi sëmundjet më të përhapura, Lipjan
- 14.** “Rifunksionalizimi i Shtëpisë së Kulturës”, Mamushë
- 15.** Vendosja e këndit të librave “Leximtarët

e rinj”, Kabash i Hasit

- 16.** Vendosja e ulëseve për banorët e fshatit Globoçicë, Dragash
- 17.** “Një kafe me trashëgiminë”, Prizren
- 18.** “Trotuare të qasshme për të gjithë”, Gjakovë
- 19.** “Çelësi i sigurisë është në duart e tua”, Pejë
- 20.** Peticion për krijimin e laboratorit të Kimisë, Pejë
- 21.** Aktivitet bamirës “Zbute dimrin pak”, Pejë
- 22.** Parkingje për biçikleta, Ferizaj
- 23.** Varëse për gjimnazin “Zenel Hajdini”, Gjilan
- 24.** Intervenim me ngjyra në hapësirë publike, Han i Elezit
- 25.** Markimi i shtigjeve të ecjes në parkun Moronica në Junik
- 26.** Ulëse për nxënësit e Qendrës së Kompetencës, Ferizaj
- 27.** Biblioteka për shkollën fillore “Nazim Kokollari”, Prizren
- 28.** Peticion për ndriçim publik në Strofc, Vushtrri
- 29.** Kërkesë për informata – DKA, Pejë
- 30.** Kërkesë për vendosjen e ndriçimit publik në Grabanicë, Klinë
- 31.** Kërkesë për informata – Policisë së Kosovës, Pejë
- 32.** Kërkesë për informata – DSHP dhe

Handikos, Pejë

**33.** Kërkesë dhe peticion për vendosjen e ndriçimit publik në Tomoc, Istog

**34.** Kërkesë dhe peticion për vendosjen e ndriçimit publik në Vitomicë, Pejë

**35.** Shfaqja teatrale “Barazia gjinore, e drejta e gruas në pronë dhe të drejtat e fëmijëve”, në Fortesë - Rahovec

**36.** “Zebra shumëngjyrëshe”, në fshatin Dubravë, Istog

**37.** Shfaqje teatrale në shkollën e mesme profesionale “Abdyl Ramaj” Shirokë, Suharekë

**38.** Kuti për grumbullimin e ankesave nga nxënësit, Deçan

**39.** Dhurim i titujve për lexuesit e shkollës fillore “Idriz Seferi”, Kaçanik

**40.** Pasurimi i bibliotekës dhe vendosja e raftit në shkollën “Nazmi Pajaziti”, Viti

**41.** Shfaqja teatrale “Barazia gjinore, e drejta e gruas në pronë dhe të drejtat e fëmijëve”, në Gjinoc - Suharekë

**42.** Rregullimi i hapësirës në shtëpine e pleqve në fshatin Gurrakoc, Istog

**43.** Shfaqja e dokumentarit “Udhëtimi virtual në monumentet e trashëgimisë kulturore”, Kijevë - Malishevë

**44.** Peticion për vendosjen e kontejnerëve për riciklim të mbeturinave, Drenas

**45.** Raft dhe libra në gjuhën boshnjake për bibliotekën e shkollës “Gërçare”, Prizren

**46.** Peticion për vendosjen e ndriçimit publik në Gllokovc, Lipjan

**47.** Peticion për renovimin e këndit të lojërave për fëmijët, Drenas

**48.** Tryezë diskutimi “Humanizmi dhe vullnetarizimi”, Lipjan

**49.** Peticion për funksionalizimin e semaforëve, Mitrovicë

**50.** Funksionalizim i parkut “Aziz Zhilivoda”, Obiliq

**51.** Ulëse për oborrin e shkollës “Gjergj Kastrioti - Skenderbeu”, Drenas

**52.** Ekspozita “Jam edhe këtu”, Vushtrri

**53.** Ligjëratë “Rëndësia dhe përfitimet e Riciklimit”, Podujevë

**54.** Renovim i oborrit të shkollës në Blinajë, Lipjan

**55.** Shfaqja teatrale “Barazia gjinore, e drejta e gruas në pronë dhe të drejtat e fëmijëve”, në Sllatinë - Fushë Kosovë

**56.** Intervenim ekologjik në rrugën “Shefqet Shkupi” në Prishtinë

**57.** “Zebra shumëngjyrëshe”, në fshatin Vrellë, Istog

**58.** Ligjëratë “Aktivizmi i të rinjve dhe rëndësia e vullnetarizmit”, Gjakovë

**59.** Ligjëratë “Orientimi në karrierë”, Prishtinë

**60.** Furnizimi i laboratorit të kimit me enë laboratorike në shkollën e mesme “Xhevdet Doda”, Prishtinë



**61.** Shfaqja teatrale “Barazia gjinore, e drejta e gruas në pronë dhe të drejtat e fëmijëve”, në Korishë - Prizren

**62.** Ligjëratë mbi Aktivizmin Qytetar, Dragash

**63.** Aksion pastrimi dhe fushatë vetëdijesuese, Mamushë

**64.** Intervenim artistik si thirrje për më shumë gjelbërim, Fushë Kosovë

**65.** Debat “Agjenda e Gjelbër e Zhupës - Sfidë apo Potencial”, Prizren

**66.** Vendosja e shportave për mbeturina, Gllloboçicë - Prizren

**67.** Ligjëratë “Përjashtimi social në shkolla”, Prizren

**68.** Promovimi i energjisë efiçiente tek qytetarët e Prizrenit

**69.** Dhurim i librave për shkollën “Mitrush Kuteli”, Prishtinë

**70.** Ligjëratë “Orientimi profesional” në gjimnazin “Sami Frashëri”, Prishtinë

**71.** Kampanjë vetëdijesuese për kujdes gjatë vozitjes, Gjakovë

**72.** Zebra shumëngjyrëshe, Prizren

**73.** Dhurim i librave për shkollën “Fehmi Agani”, Klinë

**74.** Murale në parkun e Moronicës, Junik

**75.** Krijimi i faqes së Facebook “OKY – Opportunities for Kosovar Youth”- Ferizaj

**76.** Krijimi i pjerrinave në rrugët e qytetit, Pejë

**77.** Fuqizimi i grave përmes ngritjes së shkathtësive artizanale, Prizren

**78.** Furnizimi i shkollës “Aleksandër Xhuvani” me harta gjeografike dhe sisteme periodike, Podujevë

**79.** Intervenim artistik në shkollën “Hivzi Sylejmani”, Fushë Kosovë

**80.** Ligjëratë mbi mbrojtjen e ambientit në Mamushë

**81.** Murale artistike në shkollën fillore “Martin Camaj”, Gurrakoc - Istog

**82.** Kutitë për grumbullimin e ankesave nga nxënësit, Kaçanik

**83.** Vendosja e filtruesve biologjik të ajrit në laboratorët e shkollës fillore “Ibrahim Fehmiu”, Prizren

**84.** Vendosja e ulëseve në oborrin e shkollës fillore “Gërçare”, Gërçare - Prizren

**85.** Biblioteka për shkollën fillore “Motrat Qiriazi”, Prizren

**86.** Intervenim në “Klasa në natyrë” të shkollës fillore “Emin Duraku”, Prizren

**87.** Shfaqje teatrale në shkollën fillore “Vaso Pashë Shkodrani” Leshan, Suharekë

**88.** Shfaqja teatrale “Barazia gjinore, e drejta e gruas në pronë dhe të drejtat e fëmijëve”, në Bardhosh - Prishtinë





S

RASTET E SUKSESIT

## 5. Prezentimi i rasteve të mira dhe atyre më pak të mira, në krahasueshmëri me rastet e suksesit në rajon dhe botë

### 5.1. Raste të aktivizmit dhe vullnetarizmit të rinjve në rajon dhe botë

Aktiviteti i organizuar i të rinjve në rajon dhe në botë flet për storje të suksesit sa i takon projekteve të realizuara me qëllim të përmirësimit të jetës në komunitet. Përfshirja e të rinjve në iniciativa të cilat kanë pasur ndikim madhor për tërë

komunitetin, nuk është diçka e re apo praktikë që i takon vetëm një shteti të caktuar.

Me qëllim të tërheqjes së paralelizmave me aktivitetin vullnetar të të rinjve në Komunitatet e Kosovës në kuadër të projektit “AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës”, në kuadër të këtij publikimi është parë e rëndësishme shpalosja e përfshirjes së të rinjve në aktivizmin në komunitet në kuadër të organizatës “SPUR - IDEAS + ACTION FOR A BETTER CITY” në USA dhe organizatës “prostoRož” në Slloveni.





**“SPUR - IDEAS + ACTION FOR A BETTER CITY”** është organizatë me bazë në komunitet e cila vepron në San Francisco, San Jose and Oakland. Qëllimi i saj është suportimi i grupeve joformale me qëllim të ndikimit në proceset e planifikimit urban dhe përmirësimit të jetës në komunitet në mënyrë të pavarur, pa pasur ndikime nga politikat qeverisëse. Kjo organizatë ofron përfshirjen në baza të rregullta të të rinjve, të cilët në mënyrë vullnetare inicojnë dhe udhëheqin projekte të ndryshme të cilat kanë për rezultat ndërmarrjen e intervenimeve direkte në hapësira të ndryshme të komunitetit. Përpos prodhimit të dokumenteve hulumtuese dhe projekteve konkrete, e rëndësishme është përfshirja e të rinjve, nxënësve dhe studentëve, në propozime të cilat japin një vizion tjetër për qytetet në të cilat kjo organizatë vepron. Këtu vënë theks promovimi i vizionit për qytete pa automjete, më shumë çiklizëm, më shumë hapësira gjelbëruese, liri e lëvizjes në trotuare etj.



“**prostoRož**” është komunitet kulturor me bazë në Slloveni që ka për synim përmirësimin e jetës në hapësirat publike dhe gjithçka që lidhet me publike. Ky komunitet ‘përdor’ të rinjt dhe fëmijët për të ekspoluar? mbi nevojat e komunitetit, praktikisht banorëve të lokaliteteve të caktuara me qëllim të adresimit të tyre në politika lokale dhe qendrore dhe përmirësimin të tyre. Ky komunitet shqyrton me kujdes problemet e adresuara nga komuniteti, dhe angazhohet në përmirësimin e nevojave të tyre duke ndërmarrë aksione direkte. Rëndësia e këtij komuniteti është në edukimin e gjeneratave të reja për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në përmirësimin e jetës në komunitet. Sipas kësaj organizate, intervenimet minimale në hapësirat publike janë aksione të mjaftueshme për të bindur të rinjt që aktivizmi i tyre ndikon në adresimin dhe përmirësimin e jetës në komunitet. Aksionet e tyre, të cilat janë ngusht të lidhura edhe me drejtoritë komunale, organizatat e tjera kulturore si dhe institucionet relevante, kanë për fokus qytetarin, me theks të rinjt dhe fëmijët, dhe kërkesat e adresuara nga ta.

## 5.2. Rastet e mira dhe ato më pak të mira – storjet e suksesit

Bazuar në aktivitetin e hulumtuar nga organizatat e ngjashme në rajon, dhe fokusi i të rinjve në iniciativat e zhvilluara atje, vihet në pah se gjithherë idetë për intervenime dhe aksione bazohen në nevojat dhe kërkesat që ata kanë në komunitetin ku jetojnë dhe veprojnë. Krahasimi me iniciativat të cilat janë ndërmarrë nga të rinjt pjesëmarrës të “Shkollës për aftësimin e të rinjve për aktivizëm në komunitet” vë në theks se disa nga problemet e adresuara kanë qenë të përsëritshme në disa shkolla dhe në disa komuna, duke dërguar në përsëritjen (e nevojshme) të iniciativave.

Për nga rëndësia e problemit të adresuar, mënyra e adresimit dhe përkrahja e iniciativës së ndërmarrë nga ana e komunitetit të gjerë (përfituesve indirekt), iniciativat e ndërmarrë nga të rinjt e Shkollës së Aktivizmit mund të grupohen në këto shtylla të suksesit:

### **KËNDËT E LEXIMIT NË OBJEKTET SHKOLLORE**

Një numër i konsiderueshëm i iniciativave të ideuara në kuadër të këtij projekti kanë patur për bazë nevojën e pasurimit të këndit të leximit në kuadër të objekteve shkollore.

Idetë për këto intervenime flasin për faktin që përkundër investimeve të mëdha në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore në të gjitha Komunat e Kosovës, nxënësit janë të privuar nga nevoja dhe e drejta e tyre për të lexuar dhe për të pasur çasje në informacion. Prandaj adresimi i kësaj mangësie që sistemi i arsimit në Kosovë është duke u ballafaquar, mund të konsiderohet si hap shumë i rëndësishëm, marrë për bazë që ky adresim vie pikërisht nga vet nxënësit.

Iniciativat për realizimin e mini-bibliotekave janë nisma që bëjnë thirrje për një angazhim institucional në të ardhmen, i cili do t'i ofronte mundësinë nxënësit kosovar që të lexojë dhe informohet më shumë. Këndet e leximit të realizuara në kuadër të këtij projekti do t'u shërbejnë jo vetëm nxënësve inicues por edhe gjeneratave që vijnë. Aksionet publike për mbledhjen e fondit të librave kanë ndikuar në një masë të madhe të individëve për t'u ndërgjegjësuar që dhurimi i librave dhe përfshirja vullnetare e tyre në këto nisma, ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve për arsimim te të rinjt.

### **MJEDISI DHE HAPËSIRAT E GJELBËRTA**

Orientimi i një numri të madh të iniciativave në përmirësimin e kualitetit të hapësirave

publike, me theks në oborret e objekteve shkollore, ka dëshmuar që të rinjt janë të interesuar për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin. Propozimi dhe përfshirja e tyre në aksione për të shtuar sipërfaqet gjelbëruese, vendosur ulëse dhe mobiluar përcjellës urban, si dhe për të instaluar sistemin e riciklimit përmes shportave të kategorizuara të mbeturinave, dëshmon që gjendja ekzistuese e mjedisit në Komunitat e Kosovës nuk ka kaluar pa u vërejtur nga të rinjt kosovar. Intervenimet e tyre mund të cilësohen si storje të suksesit, marrë për bazë që flasin për aktivizmin dhe vullnetarizmin e tyre për të përmirësuar gjendjen e mjedisit tonë.

### **DISKUTIMET MBI BARAZINË GJINORE**

Interesimi i madh i nxënësve të shkollave të ndryshme në Komunitat e Kosovës për të përcjellur një aktivitet kulturor, përkatësisht shfaqjen teatrale që kishte për bazë tema nga raporti gjinor dhe e drejta në trashëgimi, flet poashtu për ndërgjegjësimin e të rinjve sa i përket barazisë gjinore dhe botëkuptimeve të ndryshme në komunitet. Përfshirja e të rinjve në diskutime lidhur me këtë temë dhe interesimi që në të ardhmen pikëvështrimet e tyre për barazinë gjinore të shënojnë ndryshime, mund të cilësohen padyshim si storje të suksesit.

Kjo iniciativë dhe nevoja e saj për t'u përsëritur në disa Komunitat të Kosovës flet poashtu për nevojën e reformimit të sistemit të edukimit përmes përfshirjes së aktiviteteve të tilla të lira dhe joformale me qëllim të diskutimit të temave të ndjeshme dhe herë-herë tabu.

### **E ARDHMJA DHE ORIENTIMI NË KARRIERË**

Mirëpritja e ligjëratës "Orientimi në karrierë në shkollat e ndryshme të Komunitave të Kosovës ka dëshmuar se të rinjt e kanë më se të nevojshme një diskutim të hapur lidhur me të ardhmen e tyre, sidomos në momentet që ata duhet të marrin vendimin e madh për përzgjedhjen e profesionit të tyre. Mungesa e një diskutimi të tillë në kuadër të procesit të rregullt mësimor është identifikuar nga ana e vet nxënësve, pjesëmarrës të Shkollës së Aktivizmit. Prandaj propozimi i kësaj iniciative mund padyshim të cilësohet si tejet e nevojshme dhe vlerë e shtuar për sistemin tonë të edukimit, nëse do të vazhdojë të aplikohet nga vet institucionet arsimore.

### **LABORATORËT DHE PUNA PRAKTIKE**

Propozimet për të përmirësuar gjendjen e laboratorëve në kuadër të objekteve shkollore në Komunitat e Kosovës, kanë identifikuar një tjetër mangësi që shkollat



ekzistuese kanë. Për më tepër, këto iniciativa kanë treguar edhe interesimin e të rinjve dhe rëndësinë që ata shohin në zhvillimin e punës praktike në kuadër të sistemit tradicional të edukimit. Prandaj nismat e ndërmarra nga ana e nxënësve për shtimin e enëve laboratorike, hartave dhe materialeve të tjera relevante mund të konsiderohen si një e arritur e projektit në përgatitjen më të mirë profesionale të të rinjve.

### **KËRKESA DHE PETICIONE**

Angazhimi i të rinjve për adresimin e shqetësimeve të tyre përmes kërkesave dhe peticioneve dëshmon për vetëdijesimin e tyre se si grup i komunitetit mund të angazhohen në përmirësimin e jetës në komunitet, duke ndikuar në politikat lokale dhe qendrore. Kërkesat për çasje në dokumente publike, për raste të caktuara të ofrimit të shërbimeve publike etj., janë vetëm disa nga çështjet të cilat janë adresuar nga ana e të rinjve. Kjo mënyrë demokratike e paraqitjes së kërkesave nga ana e tyre si grup i marginalizuar i shoqërisë tonë, dëshmon për fuqizimin e tyre përmes mekanizmit të projektit "AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës".

Përpos rasteve të cilat mund të cilësohen si storje të suksesit, disa nga iniciativat e propozuara nga ana e të rinjve aktiv në kuadër të projektit, mund të cilësohen si më pak të mira, apo më pak të suksesshme. Njëindikator në kategorizimin e tyre në më pak të suksesshme është fakti që ato nuk kanë gjetur aplikim/përsëritje krahasuar me iniciativat e mësipërme. Indikator tjetër mund të konsiderohet fakti që nuk janë përcjellur me diskutim në rrjetet sociale.

E tëra kjomund të ndërlidhet me faktin që iniciativat e cilësisë së intervenimeve direkte kanë ngjallur më shumë interesim në rradhët e përfituesve direkt dhe indirekt të aksioneve, përderisa iniciativat e llojit të kampanjave vetëdijesuese apo tryezave të diskutimit janë forma tashmë të konsumuara të aktivizmit në komunitet, dhe si rezultat nuk kanë ngjallur shumë interesim.

Prandaj si më pak të suksesshme mund të konsiderohen:

### **KAMPANJAT VETËDIJESUESE**

Adresimi i tematikave të cilat shqetësojnë komunitetin përmes kampanjave vetëdijesuese është formë tashmë e përsëritur dhe si e tillë nuk ka ngjallur

shumë interesim në krahasim me intervenimet direkte.

### **TRYEZAT E DISKUTIMIT**

Diskutimet mbi tematika të cilat shqetësojnë të rinjt përmes tryezave të diskutimit ka rezultuar të jetë më pak efektive se sa një intervenim direkt. Kushtimisht të rinjt janë treguar më shumë të interesuar në realizimin e një iniciative p.sh. rregullimin e një pjerrinë për persona me aftësi të kufizuara dhe eliminimin konkret të problemit të tyre me çasshmërinë, se sa diskutimin dhe mundësitë teorike për të përmirësuar këtë çështje (të cilat diskutime rëndom kanë përfunduar pa ndonjë ndikim konkret në eliminimin e problematikave).

### **5.3. Çka tutje? Grupet e së ardhmes**

Nga punëtorja përmbyllëse e projektit “AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës” kanë rezultuar si të nevojshme formimet e pesë grupeve joformale të cilat do të kenë për fokus trajtimin e katër temave respektive.

#### **GRUPI 1 – EDUKIMI JOFORMAL**

I fokusuar në Komunën e Prishtinës, Komunën e Podujevës dhe Komunën e Fushë Kosovës, ky grup do të ndërmarrë iniciativa në zhvillimin e edukimit joformal i cili do të ketë për qëllim aftësimin e të rinjve për tematika dhe fushëveprime të ndryshme.

#### **GRUPI 2 – LUFTIMI I DUKURISË SË BULLIZMIT**

I fokusuar në Komunën e Drenasit, Komunën e Lipjanit, Komunën e Mitrovicës, Komunën e Obiliqit, Komunën e Skënderajt dhe Komunën e Vushtrrisë, ky grup do të ndërmarrë aksione dhe fushata vetëdijesuese për luftimin e dukurisë së bullizmit në shkolla, duke synuar eliminimin e rasteve të ngacmimeve të ndryshme.

#### **GRUPI 3 – SPORTI DHE SHËNDETI**

I fokusuar në Komunën e Gjilanit, Komunën e Ferizajt, Komunën e Shtimes, Komunën e

Kaçanikut, Komunën e Kamenicës, Komunën e Hanit të Elezit dhe Komunën e Shtërpcës, ky grup do të angazhohet në përmirësimin e komponentes së zhvillimit të aktiviteteve sportive në kuadër të shkollave, e cila do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë edhe në cilësinë e shëndetit të nxënësve.

#### **GRUPI 4 - AKTIVIZMI I TË RINJVE NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT**

I fokusuar në Komunën e Pejës, Komunën e Deçanit, Komunën e Junikut, Komunën e Klinës dhe Komunën e Istogut, ky grup do të angazhohet në promovimin e attributeve turistike të këtij rajoni, përmes realizimit të materialeve promovuese dhe aktiviteteve përcjellëse.

A vertical yellow strip of paper with a torn bottom edge, positioned on the left side of the page.

6

REKOMANDIMET

## 6. Konkluzë dhe rekomandime

Udhëzuesi "AKTIVIZMI NË KOMUNITET - Libërth mbi praktikën e mirë në komunitet" jep këto rekomandime:

### ***për institucionet arsimore të nivelit qendror dhe lokal***

- ⊙ Angazhimin në gjetjen e modaliteteve për nxitjen e aktivizmit dhe vullnetarizmit në mesin e të rinjve;
- ⊙ Ofrimin e mundësive të përfshirjes së të rinjve në procese vendimmarrëse dhe projekte, përfituese të të cilave janë direkt apo indirekt vetë të rinjt;
- ⊙ Angazhimin e të rinjve në identifikimin e nevojave të tyre dhe motivimin për adresimin e tyre përmes metodologjive të ndryshme;
- ⊙ Trajtimin e të rinjve si grup i barabartë me grupet e tjera të komunitetit;
- ⊙ Angazhimin e të rinjve në aktivitete jashtë kurrikulare;
- ⊙ Promovimin e aktivizmit dhe vullnetarizmit.

### ***për organet qeverisëse në Komunitet e Kosovës***

- ⊙ Gjetjen e modaliteteve për zbutjen e nivelit të përjashtimit social të të rinjve (me theks në zonat urale);
- ⊙ Angazhimin e të rinjve në nisma të aktivizmit dhe vullnetarizmit në baza të rregullta vjetore;
- ⊙ Përfshirjen e të rinjëve në diskutime publike lidhur me investimet kapitale në hapësirat ku ata jetojnë dhe veprojnë si dhe marrjen në konsideratë të kërkesave dhe shqetësimeve të adresuara nga ana e tyre;
- ⊙ Promovimin e aktivizmit dhe vullnetarizmit.

### ***për të rinjt***

- ⊙ Promovimin dhe mbajtjen gjallë të shpirtit aktivist;
- ⊙ Angazhimin vullnetar në të mirë të komunitetit;
- ⊙ Angazhimin në aktivitete jashtë kurrikulare;
- ⊙ Përfshirjen në situata vendimmarrëse, diskutime publike dhe ngjarje me interes për të ardhmen e komunitetit;
- ⊙ Adresimin e pakompromis të shqetësimeve, kërkesave dhe ideve të tyre në institucione relevante.

A vertical yellow sticky note is attached to the left side of a light-colored, textured background. The note has a slightly irregular, torn edge at the bottom.

7

PÉR EC

## EC Ma Ndryshe

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar ne vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur oranzim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.


Nga janari I vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim I komunitetit), Qeverisja e mire (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim I dijes). EC angazhohet për qytete/komuna gjithëpërfshirëse në Kosovë. Organizata beson në vlerën e shtuar që sjell angazhimi I gjithësecilit në qeverisjen e qyteteve/komunave dhe në veçanti e atyre që kanë më pak qasje dhe mundësi për të ndikuar. Në punën e saj 13 vjeçare EC është fokusuar në mobilizimin e komunitetit duke u dhënë prioritet grupeve të nën përfa-

- qësuara. Ky angazhim e ka vendosur EC-in në krye të organizatave të komunitetit në Kosovë. Një nga metodologjitë dalluese të EC-it është ajo e planifikimit urban me pjesëmarrje, rezultatet e së cilës janë tejet të prekshme në komunën e Prizrenit.

Për shumë qytetarë të Prizrenit, por edhe për disa lokacione të tjera në Kosovë, EC shihet si adresë shumë kredibile për çuarjen tutje të nevojave, kërkesave dhe interesave komunitare. EC ka punuar dhe vazhdon të punëojë ngushtë me PAK, të moshuarit, grate dhe vajzat, banorët e lagjeve informale, komunitetet jo shumicë, artistët, ambientalistët dhe shumë të tjerë në baza ditore në përpjekjen e përbashkët për t' l kthyer nevojat e qytetarëve në vendime e veprime të institucioneve. Në të njëjtën kohë, EC ka ndërtuar grupe lokale të komunitetit në nivel të lagjes dhe fshatit në komunën e Prizrenit, ndërsa nga viti 2018 këtë praktikë po e bart edhe në komunat e tjera të Kosovës (derinë2020 synohet zgjerimi deri në dhjetë komuna). Përveç angazhimit komunitar, EC njihet edhe për avokimin konsistent në mbrojtje të strukturës urbane të qyteteve të Kosovës, me fokus në vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Përmes rrjetit të gjerë të profesionistëve me të cilët bashkëpunon në

baza të rregullta, EC ka zhvilluar standard të larta të cilësisë sa i përket shërbimeve që i ofron dhe produkteve që i realizon. Organizata ka qenë dhe vazhdon të jetë kontribuese e drejtpërdrejtë e hartimit të një numri të konsiderueshëm politikash publike në nivel qendror dhe lokal. Në të njëjtën kohë, EC ka presence të shtuar edhe rajonale dhe ndërkombëtare përmes mekanizmave të rëndësishëm të rrjetëzimit profesional dhe të shoqërisë civile.





[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)